


PLANI STRATEGJIK


2016 - 2018

PËRMBAJTJA


HYRJE	5
<u>Misioni</u>	7
<u>Vizioni</u>	7
<u>Vlerat</u>	7
<u>Supozimet</u>	8
<u>Rreziqet dhe Sfidat</u>	8
FJALORI I TERMINOLOGJISË	10
SHTYLLAT STRATEGJIKE	11
SHTYLLA I: FUQIZIMI I STRUKTURËS DHE KAPACITETEVE INSTITUCIONALE TË SISTEMIT PROKURORIAL	11
Objektiva strategjike 1.1	
<i>Ngritja e përgjegjësisë institucionale dhe përditësimi i procesit buxhetor</i>	11
Objektiva strategjike 1.2	
<i>Krijimi i një procesi të emërimit, përbërjës dhe statusit të KPK-së që është në përputhje me standardet Evropiane</i>	12
Objektiva strategjike 1.3	
<i>Qartësimi i rolit dhe strukturës organizative të Sekretariatit</i>	14
Objektiva strategjike 1.4	
<i>Ngritja e planifikimit të politikave</i>	15
Objektiva strategjike 1.5	
<i>Miratimi i proceseve që do përdorë KPK-ja për hartimin dhe miratimin e rregulloreve dhe akteve tjera nënligjore</i>	15
Objektiva strategjike 1.6	
<i>Përmirësimi i koordinimit ndërmjet KPK-së, Sekretariatit të KPK-së dhe Prokurorive</i>	15
Objektiva strategjike 1.7	
<i>Përmirësimi i koordinimit të veprimeve me organe ndërkombëtare dhe organe tjera kombëtare, si me Ministrinë e Drejtësisë, Institutin Gjyqësor të Kosovës, Policinë e Kosovës dhe Odën e Avokatëve</i>	16



SHTYLLA II: PROMOVIMI I KOMPETENCAVE DHE PROFESIONALIZMIT	16
Objektiva strategjike 2.1	
<i>Ngritja e stabilitetit të mandatit të prokurorëve</i>	16
Objektiva strategjike 2.2	
<i>Caktimi i kriterëve transparente dhe proceseve të rekrutimit për prokurorë, sigurimi i kompetencave të nevojshme profesionale</i>	17
Objektiva strategjike 2.3	
<i>Rishikimi i statusit prokurorial dhe personelit të KPK</i>	17
Objektiva strategjike 2.4	
<i>Rritja e diversitetit gjinor dhe etnik në rekrutimin e prokurorëve dhe stafit administrativë</i>	17
Objektiva strategjike 2.5	
<i>Krijimi i rrugëve të qarta të karrierës brenda institucionit prokurorial</i>	17
Objektiva strategjike 2.6	
<i>Fuqizimi i menaxhimit të burimeve njerëzore dhe planifikimi</i>	17
Objektiva strategjike 2.7	
<i>Krijimi i standardeve të larta etike për prokurorë dhe personelin për mbështetje prokuroriale</i>	18
Objektiva strategjike 2.8	
<i>Paraqitje të indikatorëve matës të performancës për Prokurori (për komponentë institucionale, prokurorë, dhe poashtu edhe për stafin mbështetës)</i>	18
Objektiva strategjike 2.9	
<i>Fuqizimi i procesit të vlerësimit për prokurorë dhe stafin prokurorial</i>	19
Objektiva strategjike 2.10	
<i>Fuqizimi i sistemit disiplinor për prokurorë dhe stafin prokurorial</i>	19
Objektiva strategjike 2.11	
<i>Dispozitë e trajnimeve specifike për prokurorë</i>	20
Objektiva strategjike 2.12	
<i>Dispozitë e trajnimeve të përbashkëta për prokurorë dhe stafë administrativë</i>	20



SHTYLLA III: ZGJERIMI I QASJES NË DREJTËSI DHE MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN	21
Objektiva strategjike 3.1	
<i>Promovimi i besimit të publikut në sistemin prokurorial përmës zgjerimit të qasjes në drejtësi të publikut</i>	21
Objektiva strategjike 3.2	
<i>Ofrimi i qasjes së publikut në raporte dhe regjistra lidhur me të dhëna prokuroriale</i>	22
Objektiva strategjike 3.3	
<i>Sigurimi i konfidencialitetit të informatave, aty ku kërkohet me ligje të Kosovës</i>	22
Objektiva strategjike 3.4	
<i>Lehtësim të qasjes në drejtësi nga minoritetet etnike dhe grupet në rrezik</i>	23
SHTYLLA IV: PËRMIRËSIMI I SHËRBIMEVE DHE TEKNOLOGJISË	23
Objektiva strategjike 4.1	
<i>Themelimi i një infrastrukture adekuate të informimit dhe teknologjisë</i>	23
Objektiva strategjike 4.2	
<i>Sigurimi i mjaftueshmërisë së shërbimeve prokuroriale</i>	23
Objektiva strategjike 4.3	
<i>Sigurimi i sigurisë adekuate për prokurorë, personelit të prokurorisë, dhe shërbimeve prokuroriale</i>	23
ZBATIMI DHE MONITORIMI I PLANIT STRATEGJIK	24
SHTOJCA 1: KONSIDERIMET E PLANIT TË VEPRIMIT	25
SHTOJCA 1: PËRMBAJTJA	25
SHTOJCA 2 - PLANI I VEPRIMIT TË KPK	43



Hyrje

Këshilli Prokurorial i Kosovës udhëhiqet nga një parim kushtetues gjithëpërfshirës i cili thotë se gjithë individët brenda kufijve të vendit do të kenë qasje të barabartë në drejtësi. Gjithashtu, Këshilli udhëhiqet nga parimet kushtetuese të cilat kërkojnë që ai të veprojë në mënyrë të pavarur, profesionale dhe të paanshme duke e respektuar natyrën shumë etnike të Kosovës dhe të drejtën e barazisë gjinore.

Këshilli ka kënaqësinë që të publikoj Planin e tij Strategjik për periudhën nga 2016 deri më 2018. Plani strategjik është mjet i udhëheqjes. Këshilli e pranon se institucionet e drejtësisë në vend janë ende në proces të ndërtimit dhe se planifikimi i kujdesshëm i hapave të ardhshëm, dhe të atyre me tutje, do të jetë shumë i nevojshëm për të siguruar se është arritur nivel lartë i qasjes në drejtësi siç parashihet me Kushtetutë.


Këshilli ofron mbikëqyrje për punën e shumë njerëzve që kanë detyra dhe përgjegjësi të ndryshme. Secili person është i rëndësishëm për sistemin prokurorial të Kosovës dhe për arritjen e synimeve të këtij plani strategjik. Këshilli e di se sistemi prokurorial i Kosovës varet nga njerëzit e tij. Ky është plani strategjik i Këshillit, si përkundër planit strategjik të Zyrës së Prokurorit të Shtetit, mirëpo në zbatimin e këtij plani, Këshilli do të marrë parasysh përfshirjen e grupeve në vijim: 1) anëtarët e KPK-së (prokurorë dhe jo prokurorë); 2) prokurorët me funksione menaxheriale; 3) prokurorët pa funksione menaxheriale; 4) stafin mbështetës në kuadër të Njësisë për Vlerësimin e Përfundimit; dhe 5) stafin mbështetës në kuadër të Sekretariatit të Këshillit.

Plani strategjik nuk ka për qëllim që ti zëvendësoj këshilltarët, menaxherët, mbikëqyrësit, prokurorët dhe stafin mbështetës. Ky plan strategjik e pranon misionin e përcaktuar nga Kushtetuta dhe pasqyron vizionin e Këshillit Prokurorial, i udhëhequr nga Kryesuesi lidhur me atë se si po përmbushet misioni i tij. Ky plan strategjik identifikon objektivat kyçe për veprimtarinë e Këshillit, veprimtari kjo e cila është e bazuar në një vlerësim të kujdesshëm të nevojave. Plani gjithashtu ofron udhëzime nga ekspertët lidhur me atë se si mund të plotësohen ato nevoja, të cilat mund të përfshijnë zgjedhjen e favorshme të një sfide apo rreziku.


Natyrisht, objektivat, duhet të kategorizohen dhe caktohen prioritetet. Prioritet i lartë u kushtohet arritjes së objektivave thelbësore dhe të rëndësishme. Objektiva është thelbësore kurdo që është pasqyrim i një mandati ligjor apo nëse për shkak të mos përmbushjes së asaj objektive një komponentë madhore e institucionit do të mund të dështonte. Një objektive është e rëndësishme kurdo që është pasqyrim i praktikave më të mira, apo atëherë kur përmbushja e asaj objektive do të përmirësojë në mënyrë thelbësore efikasitetin dhe efektivitetin e institucionit apo për shkak se është i lidhur me një kërkesë të së ardhmes, duke parashikuar vjetërsimin apo dështimin e një pajisjeje ose shtimin e personelit.

Ky dokument është rezultat i shqyrtimit nga ana e Këshillit të secilës nga këto objektiva strategjike dhe si i tillë paraqet zgjidhje të zbatueshme për secilën nevojë, sfidë dhe rrezik të identifikuar. Pas paraqitjes së të gjeturave në lidhje me vlerësimin e nevojave, Këshilli ka përcaktuar së cilat janë mjetet më efikase dhe më efektive për të arritur objektivat e tij të identifikuar dhe për të zgjidhur sfidat e pritshme të cilat kanë shpër në drejtim të zhvillimit të vizionit dhe objektivave të identifikuar në këtë plan strategjik.

Në analizën e fundit, plani strategjik përcakton pikësynimet dhe definon suksesin në kushte që objektivisht janë të matshme si dhe në një format që është transparent. Më e rëndësishmja, Këshilli është kujdesur që të sigurohet që çdo objektive e identifikuar në planin e vet strategjik të jetë e arritshme në aspektin financiar, burimor dhe praktik në kontekstin e rreziqeve dhe supozimeve të



njohura. Më këtë plan, KPK do të pajiset për t'i përmbushur përgjegjësitë dhe të ketë lirinë e veprimit në një mënyrë e cila është e dizajnuar për t'i arritur objektivat e caktuara nga Kushtetuta e Kosovës dhe korniza ligjore e cila vlen për Këshillin dhe që është relevante me rolin mbikëqyrës të Këshillit ndaj Prokurorit të Shtetit. Natyrisht që do të bëhet një monitorim dhe vlerësim i Planit Strategjik të Këshillit, duke përfshirë Planin e Veprimit për zbatimin e strategjisë që do të sigurote arritjen e objektivave strategjike të Këshillit brenda një periudhe afatgjate, poashtu edhe qëndrueshmërinë e këtyre reformave dhe që mbikqyrja nga Këshilli poashtu do të frymëzonte besimin e publikut në sistemin prokurorial.



Misioni, Vizioni, Vlerat, Supozimet, Rreziqet dhe Sfidat

1. Misioni

Këshilli është i përkushtuar ndaj një standardi të përsosmërisë duke i ofruar të gjithë qytetarëve të Kosovës hetim dhe ndjekje penale më efikase dhe më efektive të kryesve të veprave penale njëkohësisht duke ofruar udhëheqësi të re në fushën e zbatimit të ligjit. KPK-ja do të luftoj që të zbatoj ligjet në mënyrë të drejtë, të paanshme dhe meritore duke i trajtuar të gjithë viktimat e krimit më dhembshuri dhe dinjitet.

2. Vizioni


Këshilli ka një vizion për sistemin prokurorial të Kosovës i cili e parasheh atë të jetë i pavarur, pasqyrues i natyrës shumë etnike të Republikës së Kosovës, i qasshëm për të gjithë, i paanshëm, i drejtë dhe efikas në hetimet dhe ndjekjet e tij, llogaridhënës për punën e tij dhe që funksionon në bazë të standardeve më të larta të ndershmërisë, integritetit, profesionalizmit dhe transparencës.

3. Vlerat

Këshilli ka përcaktuar kufijtë e sjelljes për anëtarët e vet, prokurorët dhe stafin mbështetës, të cilat janë të paraqitura në Kodin e Etikës Profesionale, sepse burimet njerëzore të pa korruptueshme dhe më parime janë një përbërës i domosdoshëm për përmbushjen më sukses të misionit që ka sistemi prokurorial. Kodi Etik kërkon nga anëtarët e Këshillit, prokurorët dhe stafi mbështetës që gjatë kohës të sillen në një mënyrë e cila promovon besimin e publikut në dinjitetin, integritetin, efikasitetin, pavarësinë dhe paanshmërinë e sistemit prokurorial. Në veçanti, anëtarët e Këshillit, nën mbikëqyrjen e Këshillit, prokurorëve dhe pjesëtarëve të stafit mbështetës do të:

- Zbatojnë standarde të larta të sjelljes profesionale dhe personale.
- Respektojnë dhe t'i binden ligjit.
- Kryejnë të gjitha detyrat në mënyrë të paanshme dhe më zell.
- Shmangin çdo sjellje dhe situatë që mund vë në pikëpyetje integritetin apo paanshmërinë e sistemit prokurorial.
- Kryejnë detyrat në bazë të standardeve dhe parimeve të pranuar ndërkombëtarisht për të drejtat e njeriut.
- Konsiderojnë interesin e publikut si bazë për të gjitha veprimet e tyre.
- Promovojnë këto parime gjatë zbatimit të kompetencave dhe ushtrimit të përgjegjësive.

Gjithashtu, secili anëtar i Këshillit pranon se ai/ajo e ka për detyrë që të veprojë në mirëbesim kurdo që është duke i zbatuar kompetencat dhe përgjegjësitë e tij/saj, duke respektuar faktet dhe procedurat në pajtim me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi. Veç kësaj, anëtarët e Këshillit pranojnë se sjellja korrekte dhe dukja e asaj sjellje, janë thelbësore në kryerjen e të gjitha aktiviteteve si anëtar i KPK-së. Në fund, këto vlera formojnë bazamentin e të gjitha ndërmarrjeve të Këshillit.



4. Supozimet


Në analizën e fundit, aftësia e KPK-së për të parashikuar qëndrueshmërinë e këtij plani strategjik varet mbi vlefshmërinë e një numri të supozimeve, si vijon:

- Kuvendi i Kosovës është plotësisht i vetëdijshëm dhe mbështetës i rolit të Këshillit Prokurorial.
- Ekziston buxhet i mjaftueshëm për funksionimin e qetë dhe të pavarur të Këshillit Prokurorial.
- Ka burime të mjaftueshme njerëzore, të afta që janë të motivuar për zbatimin e Planit Strategjik.
- Ekziston gatishmëri e mjaftueshme nga ana e donatorëve dhe partnerëve ndërkombëtarë për të mbështetur funksionimin e Këshillit Prokurorial.
- Këshilli Prokurorial ka një ekip kompetent të menaxhimit që është i angazhuar për të zbatuar bashkërisht të gjitha masat strategjike dhe të udhëheq Këshillin në realizimin e misionit të tij.
- Anëtarët e stafit të Këshillit Prokurorial janë të motivuar dhe të gatshëm për të zbatuar masat e parapara.
- Ekziston një kuptim i përbashkët rreth nevojave të Këshillit Prokurorial dhe një angazhim i fortë në lidhje me masat e nevojshme për të zbatuar Planin Strategjik.
- Ekziston një zbatim i strikt i parimeve të monitorimit dhe vlerësimit për të siguruar që janë kryer detyrat specifike të përgjegjësive të zbatimit, që janë vendosur afatet kohore dhe afatet, që po bëhet raportimi i rregullt i progresit, dhe që Këshilli Prokurorial është i zellshëm në mbikëqyrjen e zbatimit të Planit të tij Strategjik.


5. Rreziqet dhe sfidat

Këshilli Prokurorial i Kosovës pranon se institucioni i prokurorisë do të përballet me shumë sfida gjatë të ardhmes së afërt, duke përfshirë:

- Plotësimin dhe të përmirësimin e kornizës ligjore, domethënë përmes ndryshimeve dhe plotësimeve përkatëse në ligjet për KPK, Zyrën e Prokurorisë Speciale dhe Prokurorin e Shtetit, si dhe zbatimin e ndryshimeve dhe plotësimeve të miratuara në vitin 2015.
- Forcimin e aftësive të prokurorëve dhe krijimin e shërbimeve të specializuara brenda Zyrës së Prokurorit të Shtetit.
- Mbështetjen e prokurorëve me përvojë për të siguruar që brenda një afati kohor të caktuar, ata të mund të përkushtohen më shumë në funksionet këshilluese dhe të mentorimit në mënyrë që të sigurojë tranzicionin dhe transferimin e njohurive tek prokurorët me më pak përvojë.
- Përforcimin e prokurorëve për të kryer hetime penale më komplekse, veçanërisht krimet e kryera gjatë ushtrimit të detyrave publike.
- Krijimin e mekanizmave që promovojnë komunikimin e rregullt dhe bashkëpunimin ndërmjet KPK-së dhe organeve tjera relevante qeveritare, duke përfshirë Policinë e Kosovës, Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Agjencinë Kundër Korrupsionit, Agjencinë Kosovare të Inteligjencës, Ministrinë e Drejtësisë të Kosovës, Institutin Gjyqësor të Kosovës, Ministrinë e Punëve të Brendshme të Kosovës, si dhe institucionet tjera relevante.
- Ofrimin e trajnimit për anëtarët e personelit të Sekretariatit në mënyrë që ata mund të kryejnë plotësisht funksionet e tyre në institucionin e prokurorisë.



- Përcaktimin dhe zbatimin e një metode të kompjuterizuar të menaxhimit të lëndëve, dhe miratimin e një metodologjie unike për numrin e dosjes në të gjitha institucionet për identifikimin e secilit rast penal.
- Shpërndarjen e të dhënave të veprimtarisë së Prokurorit të Shtetit në mënyrë që të përforcojë besimin e publikut në sistemin prokurorial, dhe për të eliminuar çfarëdo perceptimi të mosndëshkimit.



Fjalori i Termave

EROL – USAID Programi Efektiv i Sundimit të Ligjit

Programi i mbështetur nga BE – Projekti i financuar nga BE për “Mbështetje për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës”

IGJK- Instituti Gjyqësor i Kosovës, ose cilido institucion pasardhës i themeluar për ofrimin e trajnimeve për prokurori.

KPK – Këshilli Prokurorial i Kosovës


PSH – Prokuroria e Shtetit

PK – Policia e Kosovës

Ligji – Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës, përveç nëse është përcaktuar shprehimisht ndryshe.

ZPD – Zyra e Prokurorit Disiplinor

NjShPP – Njësiti për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë



Shtyllat Strategjike

Katër shtyllat strategjike të cilat e përbëjnë këtë Plan përfaqësojnë në mënyrë të gjerë aspiratat e të gjithë komunitetit të drejtësisë së Kosovës. Plani dhe Objektivat Strategjike të tij janë të dizajnuara për të siguruar që janë arritur synimet e Planit Strategjik.

Plus, informacioni në Shtojcën 2 siguron që secili Objektiv Strategjik përmban skicën e Planit të Veprimit për të përmbushur qëllimet e Objektivit Strategjik.

Qëllimi i hartuesve të këtij dokumenti ishte për të dhënë detaje të mjaftueshme brenda Planit për të lejuar monitorimin e jashtëm të progresit drejt arritjes së secilit Objektiv Strategjik.

Plani gjithashtu pranon se një plan veprimi më i detajuar, i ndërtuar mbi përshkrimin që përmban ky dokument bashkë me matricën në Shtojcën 2, do të jenë të nevojshme për të arritur secilin nga Objektivat Strategjike të përfshira në këtë Plan Strategjik.

Shtylla I: fuqizimi i strukturës dhe kapaciteteve institucionale të sistemit prokurorial

Administrimi i shërbimeve të drejtësisë të kryera nga sistemi prokurorial duhet të jetë i drejtë, i saktë, i përshtatshëm, efikas dhe efektiv, i cili kërkon planifikim të kujdesshëm, aftësi të veçanta specifike, përdorim efikas të burimeve, monitorim, vlerësim dhe koordinim ndërmjet secilit individë dhe komponent të sistemit. Për t'u arritur sukcesi, duhet që çdo aspekt administrativë i sistemit të funksionojë me kapacitetin me të përshtatshëm të mundshëm, dhe në të njëjtën mënyrë duhet të bëhen përmirësimet aty ku është e nevojshme me qëllim për të bërë procesin më efikas dhe efektiv.


Objektiva strategjike 1.1 *Ngritja e përgjegjësisë institucionale dhe përditësimi i procesit buxhetor*

Neni 13 i Ligjit përcakton se Këshilli “menaxhon buxhetin vjetor për Këshillin dhe prokuroritë në mënyrë të pavarur” si dhe thekson se Këshilli “bartë përgjegjësi për mbikëqyrjen e shpenzimeve, alokimin e fondeve, mirëmbajtjen e llogarive të sakta dhe aktuale dhe kryerjen e auditimeve financiare.”

Këshilli do të mbrojë investimin e parave publike në sistemin prokurorial, dhe do të sigurojë që buxheti është planifikuar, ekzekutuar, monitoruar, dhe vlerësuar si duhet, dhe i kryen këto detyra në atë mënyrë që promovon objektivat e drejtësisë përderisa frymëzon besimin në menaxhimin e institucionit të fondeve publike.

Procedurat e duhura buxhetore dhe të prokurimit janë qenësore për t'u arritur objektivat e këtij Plani Strategjik. Realitetet buxhetore do të ndikojnë në vendimet e marra nga Këshilli dhe lidhur me këtë Këshilli e pranon se ka nevojë të mirren vendime se si do të alokohen burimet e tij financiare dhe të priorizojë veprimtaritë në përputhje me kufizimet buxhetore. Rrjedhimisht, Këshilli do të marrë hapa për të siguruar kontroll adekuat buxhetor në pajtim me ligje relevante.

Ndër detyrat tjera në këtë fushë, Këshilli zbaton nenin 13 të Ligjit me ndryshime dhe plotësime, që përcakton se Këshilli përgatit draft buxhetin vjetor dhe e dorëzon atë drejtpërdrejtë në Kuvend për shqyrtim dhe miratim. Kjo është një përgjegjësi e re dhe e konsiderueshme. Më parë, Këshilli është obliguar që ta dorëzojë draft buxhetin në Qeveri, dhe ka qenë Ministri i Financave dhe Ekonomisë që e ka dorëzuar atë në Kuvend.




Objektiva strategjike 1.2 *Krijimi i një procesi të emërimit, përbërjes dhe statusit të KPK-së që është në përputhje me standardet Evropiane*

Këshilli Prokurorial i Kosovës luan një rol jetik për të siguruar se shërbimi i prokurorisë është i pavarur, profesional, i paanshëm, dhe pasqyron shumëllojshmërinë etnike dhe gjinore të Kosovës. Për të kryer këtë rol të rëndësishëm nevojitet të sigurohet që vendimmarrja e tij është e cilësisë më të mirë të mundshme, dhe se procesi dhe infrastruktura është në përputhje me standardet evropiane. Para përfundimit të periudhës kohore të mbuluar nga ky plan strategjik, KPK do të funksionojë në mënyrë të pavarur, të paanshme, efikase, dhe profesionale. Këshilli do të marrë vendime cilësore në bazë të njohjes së mirë të fakteve, duke përfshirë përdorimin e raporteve dhe të dhënave kur është e nevojshme për të marrë vendime të mira. Këshilli do ketë një strukturë që përkrah funksionet e tija të rëndësishme. KPK dhe anëtarët e tij do të kenë mbështetjen e nevojshme për të ndihmuar ata në kryerjen e funksioneve të tyre të rëndësishme. Prandaj, anëtarët e KPK-së do të kryejnë trajnimet e duhura e të nevojshme për të ndihmuar ata në kryerjen e këtyre funksioneve të rëndësishme.

Këshilli Prokurorial i Kosovës ka një rol kyç në përmbushjen e funksioneve të shërbimit prokurorial dhe për këtë arsye duhet të zhvillojë në maksimum kapacitetin shqyrtues për përmbushjen e këtij roli. Për arritjen e këtij qëllimi, ndryshimet dhe plotësimet e miratuara në vitin 2015 e fuqizojnë deri në një masë të caktuar Këshillin dhe infrastrukturën e tij në mënyrë që të lehtësojnë arritjen e objektivave të këshillit në mënyrë efikase dhe efektive, dhe veçanërisht për të ruajtur rolin e vet në ofrimin e mbikëqyrjes dhe udhëzimeve të pavarura për shërbimin prokurorial. Për shembull:

- Këshilli të ketë 13 anëtarë, 10 nga të cilët duhet të jenë prokurorë, duke përfshirë Kryeprokuroren e Shtetit *ex officio*, ndërsa tre anëtarët tjerë duhet të përfshijnë një profesor universitar të juridikut, një anëtar të Odës së Avokatëve dhe një anëtar të pavarur nga shoqëria civile me shkollim universitar në juridik dhe me përvojë në fushat përkatëse të drejtësisë.
- Neni 5A i Ligjit me ndryshime dhe plotësime tani parasheh zgjedhjen e Kryesuesit të Këshillit nga radhët e anëtarëve të Këshillit që janë prokurorë, duke përcaktuar kështu që kryesuesi nuk është domosdoshmërisht Kryeprokurori i Shtetit.
- Për të siguruar që Këshilli të ketë *kuorum* në disa raste të caktuara specifike, neni 12.2 i Ligjit me ndryshime dhe plotësime përcakton *kuorumin* prej gjashtë deri në nëntë anëtarë. Ky është një përmirësim i rëndësishëm për të rritur efikasitetin e Këshillit. Për shembull, Komisioni Disiplinor i Këshillit përmban tre anëtarë të Këshillit që nuk mund të marrin pjesë në shqyrtime të Këshillit në lidhje me rekomandimet disiplinore të Komisionit, poashtu edhe Ministri i Drejtësisë, i cili ishte anëtar *ex officio* i Këshillit dhe nuk ka marrë pjesë në diskutime disiplinore për shkak të mundësisë që ai të involvohet në një rol tjetër në këtë proces. Rrjedhimisht, më parë Këshilli nuk kishte mundësi të marrë vendime përfundimtare në çështjet disiplinore sepse vetëm pesë anëtarë ishin në dispozicion për të vendosur, por për të arritur *kuorumin* e nevojshëm për vendimmarrje duhet të ishin gjashtë anëtarë. Përveç kësaj, ka pasur raste në të cilat *kuorumi* nuk kishte mundësi të arrihet për shkak të mungesës së anëtarëve të Këshillit.
- Për të siguruar pavarësinë e anëtarëve të Këshillit, neni 10 i Ligjit me ndryshime dhe plotësime përcakton se anëtarët nuk bartin përgjegjësi penale për vendimet, opinionet dhe veprimet që marrin gjatë ushtrimit të detyrës si anëtarë të Këshillit.




Për më tepër, të gjithë anëtarët e KPK-së e kryejnë rolin e tyre të rëndësishëm si anëtarë me orar të shkurtër, ndërsa në të njëjtën kohë kryen funksione të tjera ose në kuadër të shërbimit/sistemit prokurorial ose gjetkë. Pa marrë parasysh statusin e tyre me orar të shkurtër, anëtarët e KPK shpenzojnë shumë kohë në kryerjen e detyrave të tyre në KPK, që shpesh përfshijnë shërbim në komisionet e Këshillit që është i vështirë për shkak të detyrave që nuk janë të lidhura me ato të nivelit si anëtarë të Këshillit. Gjatë vitit 2014, KPK është takuar përafërsisht një herë në çdo dy javë, që ka kërkuar nga anëtarët që ti kushtojnë kohë dhe burime të konsiderueshme kryerjes së detyrave të tyre në Këshill si dhe njëkohësisht të kryejnë detyrat e tyre në punën e tyre të përhershme. Për më tepër, anëtarët e Këshillit pritet që të përgatiten për takime dhe të kryejnë detyra të tjera të rëndësishme të tilla si shërbimi i tyre në komisione *ad hoc* apo komisione të përhershme apo në grupe punuese. Neni 8 i Ligjit me ndryshime dhe plotësime përmban dispozita të tjera për ndërprerjen e statusit të anëtarit të Këshillit në rrethana të caktuara, duke përfshirë kur anëtari nuk përmbush detyrat dhe/ose obligimet e tij/saj, kryen shkelje të detyrës, në rast të sëmundjes, dhe pamundësisë së kthimit në detyrë brenda tre muajve, nuk merr pjesë në mbledhjen e këshillit për tre muaj, jep dorëheqje, ndërron jetë dhe kështu me radhë. Në këtë kontekst, Këshilli i kushton vëmendje të veçantë, aftësisë së anëtarit për përmbushjen e përgjegjësisë të tij/saj.

Shërbimet mbështetëse për KPK-në dhe anëtarët e tij më parë përcaktoheshin në ligjet relevante dhe atë në mënyra të ndarë: (a) Njësiti për vlerësimin e performancës i KPK-së sipas nenit 15 të Ligjit për KPK-në, dhe b) mbështetja administrative e ofruar nga Zyra e Sekretariatit të Kryeprokurorit të Shtetit sipas nenit 12 të Ligjit për Prokurorin e Shtetit dhe nenit 14 dhe 14A të Ligjit për KPK. Përderisa Sekretariati i Kryeprokurorit të Shtetit kryente përgjegjësitë e tij të përbashkëta në kapacitetin më të mirë të tij, ky ishte një mjedis sfidues për shkak të shqetësimeve të burimeve, dhe përgjegjësisë të përziera mund të shkaktojë një perceptim se Këshilli, detyrimi i të cilit ishte mbikëqyrja në lidhje me Prokurorinë e Shtetit, nuk është sa duhet i pavarur. Megjithatë, Nenet 14 dhe 14A të Ligjit me ndryshime dhe plotësime përvaktojnë themelimin e Sekretariatit në kuadër të KPK-së, si dhe pozitën e Dejtorit të Sekretariatit.

Këshilli do të ndërmarrë hapa të mëtutjeshëm për të ruajtur realitetin dhe paraqitjen e pavarësisë, objektivitetit dhe paanshmërisë së Këshillit, si dhe për të promovuar efikasitetin. Në funksion të kësaj dhe të vetëdijshëm për përgjegjësitë e mbikëqyrjes së Këshillit në lidhje me Zyrën e Prokurorit të Shtetit, Këshilli do të marrë hapa për të ruajtur pavarësinë nga Zyra e Prokurorit të Shtetit (ZPSH), e cila gjithashtu do të shmang çdo paraqitje të konfliktit.

Neni 8A i Ligjit me ndryshime dhe plotësime parasheh pesë komisione të përhershme: Komisionin për Çështje Normative, Komisionin për Buxhet, Financa dhe Personel, Komisionin për Administrimin e Prokurorive, Komisionin Disiplinor dhe Komisionin për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve si dhe mundësinë e krijimit të komisioneve të përkohshme (*ad hoc*) ose të përhershme kur kërkohet sipas rrethanave, gjë kjo që vendos përgjegjësi dhe barrë shtesë mbi anëtarët. Për shkak të natyrës dhe gamës së përgjegjësisë të Këshillit si dhe ngarkesës së madhe të punës për anëtarët e Këshillit që e pengon Këshillin që të veprojë në nivel maksimal të efikasitetit dhe efektshmërisë, Këshilli do të marrë hapa për përmirësimin e kapacitetit të komisioneve të tij të përhershme dhe *ad hoc*, si dhe për fuqizimin e aftësive të personelit.

Përfundimisht, Këshilli do të përmirësojë punët e tija të brendshme në përpjekje për të lehtësuar efikasitetin dhe efektivitetin e tij si dhe të fokusohet në zbatimin e kërkesave të përcaktuara në Ligjin me ndryshime dhe plotësime.




Objektiva strategjike 1.3 *Qartësimi i rolit dhe strukturës organizative të Sekretariatit*

Megjithëse Sekretariati i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit ka ofruar mbështetje për Këshillin, nenet 14 dhe 14A të Ligjit me ndryshime dhe plotësime kanë themeluar Sekretariatit e Këshillit dhe Drejtorin e Sekretariatit që është përgjegjës për:

- Të ndihmuar në zbatimin e rregullave, rregulloreve dhe politikave të Këshillit lidhur me menaxhimin, buxhetin dhe administrimin e prokurorive;
- Zhvillimin dhe propozimin për miratim nga Këshilli të rregullave administrative të nevojshme për zbatimin e urdhrave të Këshillit;
- Propozimin në Këshill të politikave, rregullave dhe rregulloreve të reja kur janë të nevojshme për administrimin efikas dhe efektiv të prokurorive;
- Raportojë në bazë të rregullt para Këshillit për punën e prokurorive dhe ofrojë rekomandime për përmirësime;
- Sipas udhëzimeve të Këshillit dhe Komisionit të tij për Buxhet, Financa dhe Personel, Sekretariati përgatitë një buxhet të konsoliduar për prokurorinë dhe administron buxhetin e miratuar të prokurorisë.
- Sipas udhëzimeve të Këshillit dhe Komisionit të tij për Buxhet, Financa dhe Personel, Sekretariati menaxhon me personelin administrativ dhe mbështetës të prokurorive përfshirë këtu alokimin e personelit administrativ dhe mbështetës në prokurori bazuar në ngarkesën me punë, mirëmbajtjen e regjistrave të personelit, sistemin e vlerësimit të performancës, sigurimin e disiplinimit të duhur të punonjësve të prokurorive si dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre të punësimit.
- Bazuar në kufizimet buxhetore dhe në udhëzimet e Këshillit, Sekretariati sigurohet që prokuroritë të kenë furnizim të duhur me materiale të nevojshme për funksionim efikas dhe efektiv të prokurorive.
- Ofron mbështetje administrative për Këshillin dhe komisionet e tij, si dhe ndërmerr detyra dhe autorizime të tjera sipas udhëzimeve të Këshillit.
- Zhvillon dhe miraton rregullore që ndërlidhen me strukturën organizative dhe funksionimin e Sekretariatit.

Drejtori është përgjegjës ndaj Këshillit për administrim efikas dhe efektiv të Sekretariatit dhe të prokurorive. Drejtori i raporton drejtpërsëdrejti Kryesuesit të Këshillit. Drejtori do të marr pjesë në të gjitha takimet e Këshillit dhe i përgjigjet të gjitha kërkesave të Këshillit për informacion. Në bazë të nenit 14A të Ligjit me ndryshime dhe plotësime, Këshilli emëron (dhe nëse është e nevojshme shkarkon) Drejtorin e Sekretariatit në përputhje me procedurat, kriteret dhe kualifikimet që zhvillohen dhe miratohen nga ana e Këshillit përmes rregulloreve, të cilat janë në pajtim me detyrimet kushtetuese



si dhe detyrimet nga rregulloret e zbatueshme të personelit.

Deri në atë masë sa Këshilli vendos të urdhërojë decentralizimin e përgjegjësive të caktuara të Sekretariatit në interes të rritjes së efikasitetit dhe efektshmërisë administrative, Këshilli do të ndërmarrë hapa për të siguruar zbatimin efikas të planit të decentralizimit.

Rrjedhimisht, Këshilli do të zbatojë ndryshimet administrative të përcaktuara në Ligjin me ndryshime dh plotësime dhe të ndërmarrë të gjithë hapat tjerë të përshtatshëm për rritjen e efikasitetit dhe efektshmërisë administrative që janë në pajtim me këtë objektiv.

Objektiva strategjike 1.4 *Ngritja e planifikimit të politikave*

Është evidente që aktualisht Këshilli ka kapacitete të kufizuara në fushën e zhvillimit të politikave dhe planifikimit, që është njëra nga përgjegjësitë kryesore të Këshillit, komisioneve të tij dhe Sekretariatit. Njësitë për Vlerësim të Performancës vepron nën drejtimin e Këshillit dhe është instrumenti kryesor për të ndihmuar KPK-në në monitorimin dhe vlerësimin e shërbimeve të prokurorive. Megjithatë, nuk ka asnjë zyre të veçantë apo zyrtar në kuadër të strukturës së KPK me përgjegjësi për koordinim të politikave, planifikim apo hulumtim. Rrjedhimisht, Këshilli do marrë hapa për të themeluar një funksion të tillë.


Në përputhje me aktivitetet e tija për zhvillimin e politikave dhe planifikimit, Këshilli do të promovojë administrimin më të mirë dhe praktikën më të mira përmes besimit në një plan strategjik, i zbatuar nga një plan i veprimit që është i monitoruar nga afër nga një grup punues, subjekt i shqyrtimeve funksionale nga Kryesuesi dhe Këshilli dhe nëse është e nevojshme, i koordinuar me Menaxherin për Financa & Buxhet.

Objektiva strategjike 1.5 *Miratimi i proceseve sipas praktikave të mira që do përdorë KPK-ja për hartimin dhe miratimin e rregulloreve dhe akteve tjera nënligjore*

Këshilli duhet të sigurojë që aktet e tij nënligjore, së bashku me Kushtetutën e Kosovës dhe ligjet përkatëse, ofrojnë për secilin aspekt të rëndësishëm të veprimeve të tij udhëzim konsekuent dhe korrekt për Këshillin, Prokurorin e Shtetit dhe të gjithë ata që punojnë në kuadër të sistemit prokurorial. Në veçanti, detyrimi për të zhvilluar dhe miratuar akte nënligjore të nevojshme dhe të duhura ashtu siç janë përfshirë për masat e theksuara në këtë Plan Strategjik. Rrjedhimisht, Këshilli do marrë hapa që janë në pajtim me këtë qëllim, duke përfshirë fuqizimin e kapacitetit të komisioneve të përhershme dhe të përkohshme të përcaktuara në nenin 8A të Ligjit me ndryshime dhe plotësime. Për më tepër, Këshilli do të ndërmarrë hapa për të siguruar që këto procese të zhvillohen sipas praktikave të mira të identifikuara ose zhvilluara nga personi ose njësi përgjegjëse për koordinimin, planifikimin dhe hulumtimin e politikave.

Objektiva strategjike 1.6 *Përmirësimi i koordinimit ndërmjet KPK-së, Sekretariatit të KPK-së dhe Prokurorive*

Këshilli duhet të ketë një mekanizëm të brendshëm të komunikimit me qëllim për të menaxhuar njësitet dhe punonjësit e tij që institucioni të shkojë drejt arritjes së objektivave të tij në mënyrë të koordinuar, efektive dhe efikase. Rrjedhimisht, Këshilli do marrë hapa të duhur për të themeluar mekanizmin e tillë.



Objektiva strategjike 1.7 Është e qartë se për të arritur më sukses objektivat e tij, Këshilli duhet të ketë marrëdhënie produktive me partner të institucioneve dhe organizatave ndërkombëtare dhe kombëtare. Rrjedhimisht, KPK do të angazhohet në disa veprimtari të vazhdueshme dhe/ apo ndërmarrë hapa tjerë për të mbajtur ato marrëdhënie produktive.

Deri në masë të duhur, Këshilli do të përmirësojë bashkëpunimin me donatorë ndërkombëtarë me qëllim për të identifikuar, miratuar, dhe mbështetur praktikatat e mira në mbikqyrjen e sistemit prokurorial të Kosovës.

Shtylla II: Promovimi i kompetencave dhe profesionalizmit

Besimi në sistemin prokurorial është thelbësor për të pasur një shoqëri të rregullt demokratike, përfshirë edhe prokurorët e pavarur. Në mënyrë të veçantë, institucioni i prokurorisë duhet të perceptohet si i drejtë, i paanshëm dhe i pavarur në kërkimin e drejtësisë dhe zgjidhjes së veprave penale të dyshuara. Për më tepër, institucioni prokurorial nuk duhet të perceptohet vetëm në këtë mënyrë, por në fakt duhet të praktikojë parimet e drejtësisë, paanëshmërisë dhe pavarësisë në çdo aspekt të punës së tij. Përveç kësaj, llogaridhënia e arritur nëpërmjet kontrollit dhe balancit është një parim themelor i qeverisjes që është miratuar në mënyrë specifike nga Republika e Kosovës. Në veçanti, populli i Kosovës ka deklaruar kur ka ratifikuar Kushtetutën e tij se “Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, sikurse parashikohet në Kushtetutë.” Këshilli Prokurorial i Kosovës është një kujdestar i këtyre parimeve të rëndësishme, dhe si një institucion publik, sistemi prokurorial pra duhet të jetë i përgjegjshëm për veprimet e tij, që do të frymëzonte besimin e publikut.

Administrimi efektiv i drejtësisë varet nga respekti për institucionin prokurorial, dhe për kompetencën, profesionalizmin dhe civilizimin e atyre të cilët janë të punësuar si prokurorë dhe staf mbështetës prokurorial. Prokurorët, stafi mbështetës prokurorial dhe anëtarët e publikut kanë të drejtë për sjellje të respektueshme dhe profesionale nga të gjithë pjesëmarrësit në sistemin e drejtësisë. Prokurorët dhe stafi mbështetës prokurorial duhet të jenë të trajnuar mirë dhe të marrin mbështetjen e duhur për të arritur përsosmërinë dhe për të plotësuar nevojat e publikut.


2.1. Objektiva strategjike 2.1 *Ngritja e stabilitetit të mandatit të prokurorëve*

Në përgjithësi, ligjet e zbatueshme i japin kompetencë Këshillit për të propozuar kandidatë për riemërim, transfer, dhe ngritje në detyrë, por një plotësim-ndryshim i Ligjit për KPK-në, për qartësimin e autoritetit të Këshillit për të pranuar kandidatë në punësim fillestar do të rriste mundësinë e sistemit prokurorial për të funksionuar. Në këtë kontekst, Këshilli do të marrë hapa për të mbështetur konsideratat e Ministrisë së Drejtësisë për një plotësim-ndryshim të tillë.

Kushtetuta parasheh emërimin e prokurorëve për një mandat fillestar, dhe ka mekanizma për të siguruar që vendimet për riemërim janë bërë në bazë të ekzaminimeve të administruara gjatë trajnimit fillestar dhe vlerësimeve të performancës të bëra gjatë mandatit fillestar. Megjithatë, Këshilli do të shqyrtojë se a janë emërimet më të gjata provuese të duhura në një afat të gjatë për shkak të potencialit për një dukje, apo që në realitet të ndërhyrjes me funksione prokuroriale dhe pavarësi prokuroriale.

2.2. Objektiva strategjike 2.2 *Caktimi i kritereve transparente dhe proceseve të rekrutimit për prokurorë, sigurimi i kompetencave të nevojshme profesionale*

Këshilli do zhvillojë dhe zbatojë një qasje proaktive dhe të bazuar në merita për rekrutimin e



dizajnuar për të gjetur dhe emëruar një fuqi punëtore që përpiket të arrijë përsosmëri dhe të plotësojë standarde të larta të sjelljes etike.

2.3. Objektiva strategjike 2.3 *Rishikimi i statusit prokurorial dhe personelit të KPK*

Anëtarët e stafit mbështetës të sistemit prokurorial, duke përfshirë stafin mbështetës të Këshillit, janë shërbyes civil, që do të thotë se Këshilli, Kryeprokurorët dhe menaxherët e Sekretariatit kanë autoritet shumë të kufizuar mbikëqyrës mbi këta punëtorë. Ricaktimi i stafit mbështetës në kategori të veçanta që i pozicionon ata nën umbrellën mbikëqyrëse të Këshillit, Kryeprokurorit, dhe/apo stafit menaxhues të Sekretariatit do të përmirësonte në masë të madhe efikasitetin dhe efektivitetin e insitucionit, posaçërisht lidhur me mundësinë e Këshillit për të udhëzuar institucionin drejt arritjes së objektivave të vendosura në Planin Strategjik. Rrjedhimisht, Këshilli do të marrë hapa të duhur për të arritur këtë qëllim.

2.4. Objektiva strategjike 2.4 *Rritja e diversitetit gjinor dhe etnik në rekrutimin e prokurorëve dhe stafit administrativ*


Këshilli Prokurorial i Kosovës e ka obligim ligjor për të siguruar që fuqia punëtore në Prokurorin e Shtetit e reflekton natyrën shumë-etnike të Kosovës. Rrjedhimisht, Këshilli do të marrë hapa të duhur për të arritur këtë qëllim.

2.5. Objektiva strategjike 2.5 *Krijimi i rrugëve të qarta të karrieres brenda institucionit prokurorial*

Këshilli e pranon se dhënia e mundësisë prokurorëve dhe anëtarëve të stafit mbështetës për të zhvilluar rrugën e karrierës duke shfrytëzuar aftësitë, arsimin, dhe interesat e karrierës së tyre njëkohësisht do të lehtësonte qëllimet dhe objektivat gjithëpërfshirëse të sistemit prokurorial sepse do të motivonte ata punëtorë për të performuar në mënyrë të suksesshme dhe efikase. Rrjedhimisht, Këshilli do të marrë hapa të duhur për të arritur këtë qëllim.

2.6. Objektiva strategjike 2.6 *Fuqizimi i menaxhimit të burimeve njerëzore dhe planifikimi*

Burimet njerëzore të shërbimit prokurorial (duke përjashtuar KPK) përfshijnë një numër të grupeve të ndryshme të njerëzve: (1) prokurorë me funksione menaxheriale; (2) prokurorë pa funksione menaxheriale; (3) staf mbështetës në kuadër të Njësitit për Shqyrtimin e Performancës; dhe (4) staf mbështetës në kuadër të Zyrës së Prokurorit të Shtetit. Të gjitha grupet janë të rëndësishme në sigurimin e një shërbimi efektiv, efikas dhe të paanshëm prokurorial. Prandaj është e rëndësishme që Këshilli Prokurorial i Kosovës, me mbështetjen e Sekretariatit (sipas nenit 14.1.6 të Ligjit me ndryshime dhe plotësime), të sigurojë që Prokurori i Shtetit të alokojë burimet e tija njerëzore me përgjegjësi në mënyrë që të përmbushet misioni i tij në mënyrë efikase dhe efektive përmes caktimit të kombinimeve optimale të aftësive, përvojave dhe konsideratave tjera, duke përfshirë numër të prokurorëve dhe stafit mbështetës në një vend të caktuar gjeografik, në lloje të veprave penale apo në çështje specifike prokuroriale në baza të përkohshme apo përhershme. Thënë kjo më shkurt, njerëzit e duhur duhet të punojnë në vende të duhura në mënyrë për të siguruar shërbim efektiv dhe efikas prokurorial. Lidhur me Kryeprokurorët dhe stafin mbështetës, Këshilli do të zhvillojë dhe zbatojë sisteme për të siguruar alokim të përshtatshëm të resurseve njerëzore që çon drejt një sistemi efektiv dhe efikas prokurorial. Rrjedhimisht, Këshilli do të marrë hapa të duhur për të arritur këtë qëllim.



2.7. Objektiva strategjike 2.7 *Krijimi i standardeve të larta etike për prokurorë dhe personelin për mbështetje prokuroriale*

Në vitin 2012, Këshilli miratoi Kodet e Etikës për Anëtarë të KPK-së, për prokurorë dhe stafin mbështetës. Janë përgatitur Komentarë për këto Kode dhe është përgatitur një grup trajnerësh për të ndihmuar në zbatimin e kodeve. Kodet janë plotësimit shtesë i detyrimeve tjera ligjore të anëtarëve të KPK-së, prokurorëve dhe stafit mbështetës për të mbajtur standarde të larta etike, duke përfshirë ato nën Ligjin për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publikë (Ligji 04/L-050) dhe Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit (Ligji 04/L-051). Rrjedhimisht, Këshilli do të marrë hapa për të forcuar standardet etike për prokurorë dhe personelin mbështetës prokurorial.

2.8. Objektiva strategjike 2.8 *Paraqitje të indikatorëve matës të performancës për Prokurori (për komponentë institucional, prokurorë, dhe poashtu edhe për stafin mbështetës)*


Këshilli mbështetet në standardet e performancës së anëtarëve të stafit mbështetës të KPK, poashtu të Kryeprokurorëve, prokurorëve dhe stafit mbështetës administrativ për dy qëllime thelbësore që janë të lidhura me përmbushjen e misionit të institucionit.

- Së pari, standardet e performancës janë mjete të themelimit të synimeve për punëtor individual të institucionit prokurorial, prandaj duhet të bëhet ndarja specifike e përgjegjësi për pjesë të planit të punës së institucionit individëve përgjegjës për zbatimin e tyre. Synimet e standardeve të performancës po ashtu janë strukturuar për të ofruar standarde të arritshme specifike të suksesit, dhe për t'u dhënë individëve një udhëzim për hapat e tyre të ardhshëm.
- Së dyti, standardet e performancës shërbejnë si një mekanizëm për vlerësimin individual të punëtorëve, për shpërblimin e performancës së lartë si dhe të arriturave të dallueshme, si bazë për korrigjimin e performancës së dobët dhe për qëllime disiplinore.

Rrjedhimisht, gjatë periudhës kohore të mbuluar nga ky Plan Strategjik, Këshilli do të marrë hapa për të përmbushur këto qëllime. Këta hapa do të përfshijnë krijimin e Komisionit për Vlerësimin e Performancës së Prokurorive sipas kërkesave të neneve 21.4 dhe 21.5 të Ligjit me ndryshime dhe plotësime, që kërkojnë që Këshilli të miratojë një rregullore për standardet e performancës që do të përdoren gjatë vlerësimit periodik të performancës së prokurorëve gjatë mandatit të tyre fillestar si dhe sipas nenit 14B që kërkon miratimin nga Këshilli të një rregullore për kriteret dhe metodat që duhet të përdoren nga Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve gjatë procedurave për ngritjen në detyrë, uljen në detyrë ose shkarkimin e prokurorëve.

Ngjashëm, Këshilli mbështetet në standarde të performancës për komponente të tija institucionale dhe në ato të Zyrës së Prokurorit të Shtetit, duke përfshirë Prokuroritë, departamentet administrative të Zyrës së Prokurorit të Shtetit, dhe departamentet administrative të Këshillit. Të njëjtat qëllime të standardeve të performancës vlejné për komponentë institucional ashtu siç i zbaton Këshilli për punëtor individual. Standardet e performancës ofrojnë një kornizë shumë të dobishme që do të udhëzonte shërbimin prokurorial drejt suksesit matës, si më poshtë:

- Së pari, standardet e performancës caktojnë synime të rëndësishme për njësitë institucionale, dhe ndajnë përgjegjësi specifike për pjesë të planit të punës së institucionit për komponentet përgjegjëse për zbatimin e tyre. Kjo ofron standarde të arritshme të suksesit, dhe i japë menaxherëve të njësiteve një udhëzues të hapave të ardhshëm.



- Së dyti, standardet e performancës shërbejnë si një mekanizëm për njësitet për vlerësim, për shpërblimin e performancës së lartë të njësiveve si dhe të arriturave të dallueshme nga njësitet, dhe si bazë për korrigjimin e performancës së dobët.

Rrjedhimisht, gjatë periudhës kohore të mbuluar nga ky Plan Strategjik, Këshilli do të marrë hapa për të përmbushur edhe këto qëllime.

2.9. Objektiva strategjike 2.9 *Fuqizimi i procesit të vlerësimit për prokurorë dhe stafin prokurorial*

Në rolin e tij mbikqyrës dhe me qëllim të ndërtimit të besimit të publikut në sistemin prokurorial, Këshilli do marrë hapa për të monitoruar dhe vlerësuar produktivitetin, efikasitetin dhe efektivitetin e prokurorive, prokurorëve, dhe stafit mbështetës.


Hapat e ndërmarra nga Këshilli do të marrin në konsideratë mënyrat për të përmirësuar performancën e individëve dhe për të siguruar që performanca e dobët mund të adresohet në mënyrë efektive në fazën më të hershme të mundur dhe të pranohet performanca e mirë. Këshilli e pranon që drejtimi efektiv i sistemit të vlerësimit të performancës mund të kërkojë që individët të trajnohen për të zgjidhur brengat lidhur me performancën. Në mënyrë aktive Këshilli do të ndërmerr hapa për të siguruar që trajnimet janë të shënjzuara në drejtim të përmirësimit të performances së individëve dhe të sistemit prokurorial në përgjithësi.

Këshilli do të konsiderojë përdorimin e standardeve të përshtatshme të performancës që shërbejnë si mekanizëm për vlerësimin e prokurorëve individual dhe të punonjësve të stafit mbështetës për shpërblimin e performancës së lartë si dhe të arriturave të dallueshme si bazë për korrigjimin e performancës së dobët dhe për qëllimet disiplinore. Përveç kësaj, Këshilli do të përcaktojë synimet për performancë individuale duke shpërndarë përgjegjësi specifike për pjesët e planit të punës së institucionit tek personat përgjegjës për zbatimin e tyre. Synimet e standardit të performancës janë gjithashtu të strukturuar për të ofruar etapa specifike të arritshme të suksesit dhe për të dhënë personave udhërrëfyesin për hapat e tyre në vijim. Rrjedhimisht, gjatë periudhës kohore të mbuluar nga ky Plan Strategjik, Këshilli do të ndërmarrë hapa për krijimin e standardeve efektive të performancës.

2.10. Objektiva strategjike 2.10 *Fuqizimi i sistemit disiplinor për prokurorë dhe stafin prokurorial*

Këshilli, në bashkëpunim me institucionet tjera është përgjegjës për kryerjen e procedurave disiplinore lidhur me ankesat e parashtruara kundër prokurorëve që hetohen nga Zyra e Prokurorit Disiplinor. Procedurat disiplinore udhëhiqen nga parimet që duhet të përcaktohen me ligj, që përfshijnë parimet e ligjshmërisë, barazisë para ligjit, supozimit të pafajësisë, *in dubio pro reo*, proporcionit, pavarësisë dhe paanshmërisë, publicitetit dhe konfidencialitetit.

Nëse një person i ndjeshëm ndaj Kodit të Etikës kupton qëllimet dhe dispozitat e Kodit, ajo njohuri do t'i ndihmojë personit në zgjidhjen e sfidave etike. Kjo qasje përfshin disiplinën pozitive dhe përfshin vet-kontrollin. Gjithashtu kjo pasqyron udhëheqësi, përkushtim, motivim dhe cilësi të tjera pozitive. Nëse në anën tjetër personi injoron Kodin e Etikës në fuqi apo shpërfill detyrën e tij/saj për të kuptuar dhe zbatuar Kodin – Kodi mund të shndërrohet në një shpatë që mund të dëmtojë karrierën e prokurorit apo stafit mbështetës si rezultat i pasojave natyrore të procesit disiplinor. Ky hap përfshin disiplinën negative dhe bazohet në potencialin për ndëshkim. Përgjegjësitë e Këshillit për disiplinë negative janë të shkarkuara tek Komisioni Disiplinor i përbërë nga tre anëtarë të Këshillit që veprojnë nën kornizën rregulluese që kërkon shqyrtim dhe rishikim.



Rrjedhimisht, Këshilli do të ndërmarrë hapa për të fuqizuar sistemin disiplinor për prokurorë dhe stafin mbështetës, duke përfshirë ndryshimet në dispozitat për procedurat disiplinore të Ligjit, të cilat (Neni 23) përcaktojnë përbërjen e re të Komisionit Disiplinor, (në Nenin 25.3) përcakton afatin e parashkrimit për ankesat disiplinore, dhe (në Nenet 29.5 dhe 29.6) përcaktojnë mundësinë e ankimit në Këshill ndaj vendimeve të Komisionit Disiplinor dhe në rastet kur ka vonesa në pranimin e lëndës nga Komisioni Disiplinor të dërguar nga Zyra e Prokurorit Disiplinor që shkakton parashkrimin.

2.11. Objektiva strategjike 2.11 *Ofrimi i trajnimeve specifike për prokurorë*

Sipas Nenit 40 të Ligjit, Këshilli është përgjegjës për krijimin e politikave, standardeve dhe direktivave për rregullimin e trajnimit të prokurorëve dhe personelit prokurorial.

Këshilli vlerëson se zhvillimi i karrierës për prokurorë dhe stafin mbështetës është në të mirë edhe për individët edhe për institucionet sepse kjo e ngrit nivelin e profesionalizmit dhe kjo gjithashtu asiston në planifikimin e vazhdueshëm, pasi që pensionimi, dorëheqjet dhe fundi i mandatit do të mund të linin një hendek në infrastrukturën e burimeve njerëzore. Këshilli do të ndërmarrë hapa të duhur për të siguruar që janë bërë përpjekje për planifikimin e vazhdueshëm.


Këshilli vlerëson se në një shkallë të madhe, ndjekjet penale të suksesshme dhe vendimet e mbështetura do të rezultojnë nga arsyetimi i mirë ligjor dhe nga aftësitë e të shkruarit të demonstruar nga prokurorët në rrjedhën e punës së tyre. Prandaj, Këshilli do të marrë hapa të duhur për të siguruar forcimin e aftësive të tilla.

2.12. Objektiva strategjike 2.12 *Ofrimi i trajnimeve të përbashkëta për prokurorë dhe staf administrativë*

Këshilli pranon se teknologjia informative është shtyllë e punës administrative dhe ligjore në sistemin modern prokurorial. Këtu duhet të cekim, gjithashtu se zhvillimi i aftësive në teknologjinë informative dhe/ ose përmirësimi i këtyre aftësive është jashtëzakonisht me rëndësi për të arritur qëllimet dhe objektivat në sistemin prokurorial të Kosovës. Në përputhje me këtë, Këshilli do të ndërmarrë hapa për të siguruar fuqizimin e këtyre aftësive.

Për më tepër, Këshilli e ndan përgjegjësinë për trajnimin e prokurorëve dhe stafit mbështetës me Institutin Gjyqësor të Kosovës dhe Institutin e Kosovës për Administratë Publike. Në veçanti, kjo përgjegjësi e përbashkët përfshin zhvillimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e programeve të trajnimit që do të rezultojë në rritjen e nivelit të profesionalizimit në fuqinë punëtore prokuroriale. Këshilli pranon se një shërbim profesional dhe efektiv prokurorial kërkon anëtarë profesional dhe fuqi punëtore efikase individuale. Këshilli do të sigurojë një program sistematik, të profesionalizmit të vazhdueshëm të KPK-së dhe Prokurorit të Shtetit, dhe do të sigurojë që performanca e mirë të bëhet e njohur dhe performanca e dobët të përmirësohet. Qëllimet e profesionalizimit përfshijnë: një nivel të lartë të njohurive dhe aftësive brenda shërbimit prokurorial, trajnim efektiv dhe të përshtatshëm dhe përdorimin e stafit mbështetës prokurorial në lehtësimin e detyrave të prokurorëve dhe sistemeve efektive të menaxhimit të performancës për të inkurajuar performancë të mirë.

Për të siguruar një shërbim profesional, të paanshëm dhe të pavarur të prokurorisë, çdo prokuror dhe staf mbështetës duhet të jetë i vetëdijshëm jo vetëm për detyrat e tij ose të saj të punës, por edhe të shumë detyrimeve në përgjithësi në lidhje me konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave personale, të etikës, dhe sjelljes profesionale (përfshirë sipas Kodeve përkatëse të Sjelljes dhe Ligjeve të tilla, por pa u kufizuar në, Ligjin për Deklarimin e Pasurive dhe Ligjit për Konfliktin e Interesit).



Përpjekjet e profesionalizimit do të jenë të rrënjësura në trajnimin që fokusohet në nevojat operacionale të prokurorisë, si dhe zhvillimin e karrierës individuale dhe planifikimin e vazhdimësisë institucionale. Në aspektin e metodologjisë, trajnimi do të përfshijë jo vetëm aktivitetet në klasë, por edhe “programe praktike në vendet e punës,” të trajnimit në vendin e punës dhe udhëzimit të sjelljes profesionale.

Shtylla III: Zgjerimi i Qasjes në Drejtësi dhe marrëdhëniet me Publikun

Kosova është e përkushtuar për të siguruar shërbime cilësore për të gjithë anëtarët e komuniteteve të saj. Është e ditur se dallimet fizike, ekonomike, gjuha, dhe diferencat të tjera mund të shërbejnë si barriera ndaj drejtësisë. Si pasojë, informacioni i kuptueshëm dhe shërbimet e duhura duhet t’i ofrohet çdo individ në mënyrë që të sigurojë qasje të hapur në sistemin e drejtësisë, dhe për të përmirësuar besimin e publikut në sistemin prokurorial.


3.1. Objektiva strategjike 3.1 *Promovimi i besimit të publikut në sistemin prokurorial përmes zgjerimit të qasjes në drejtësi të publikut*

Ndërgjegjësimi i publikut lidhur me sistemin prokurorial mbetet i ulët. Niveli arsimor i popullsisë dhe qëndrimet konservatore të komuniteteve kufizojnë qasjen në drejtësi. Gratë dhe vajzat e reja shpesh e gjejnë të vështirë për të raportuar një krim. Një qasje e integruar për parandalimin e krimit dhe hetimit, e cila i bashkon të gjitha institucionet e drejtësisë (përfshirë policinë), shoqërinë civile dhe grupet e komunitetit, po ecën ngadalë.

Një sistem i prokurorisë nuk mund të konsiderohet i suksesshëm nëse ai nuk ofron hetime dhe ndjekje penale të drejtë, të paanshme, jo diskriminuese për qytetarët që kanë nevojë, duke përdorur mekanizma të besueshëm, transparente, efektive dhe të qëndrueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe për të mbrojtur të drejtat, duke përfshirë edhe dënimin e krimeve dhe kompensimin për viktimat. Prandaj është thelbësore që të vazhdohet të zbatohen në mënyrë më efektive fushata të ndërgjegjësimit dhe informuese mbi ligjet dhe të drejtat e qytetarëve në mënyrë që popullata të kupton dhe të kërkon mbrojtjen e të drejtave të saj.

Në kapacitetin e tij si mbikëqyrës i sistemit të prokurorisë, Këshilli pranon se disa nga sfidat kryesore në qasje në sistemin të prokurorisë janë të lidhura me:

- Sigurimin se vetëdija e përkatësisë gjinore dhe ndjeshmëria ndaj të drejtave të fëmijëve janë të përfshira në programet dhe veprimtaritë e sektorit të prokurorisë.
- Rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit të publikut për ligjet, të drejtat dhe mekanizmat në dispozicion për zbatimin e të drejtave, veçanërisht në mesin e grave dhe vajzave të reja.
- Rritjen e kapacitetit të institucioneve në sektor për të ofruar shërbime dhe për të trajtuar rastet ligjore shpejt dhe në mënyrë efektive për të rritur besimin e publikut në sistemin e prokurorisë dhe për të reduktuar perceptimin e mosndëshkimit.
- Përmirësimin e mekanizmave të tjera alternative jo-juridike për zgjidhje të kontesteve, për shembull, ndërmjetësimet dhe arbitrazhet.
- Rritjen e një sistemi të integruar dhe efektiv të ndihmës ligjore dhe mbështetjes gjyqësore, veçanërisht për popullatën e dëmtuar dhe të pambrojtur, kryesisht përmes përforsimit të rolit të avokatëve dhe zbatimit të sistemeve të mbrojtjes për dëshmitarët dhe personat në nevojë (për shembull, identitet të fshehur, strehimoret), por edhe përmes përjashtimit të tarifave dhe ngarkesave, pagesën e shpenzimeve të udhëtimit, e të tjera.



Kështu, gjatë periudhës së mbuluar nga ky plan strategjik, Këshilli do të ndërmarrë hapa që të përmirësojë besimin e publikut në sistemin prokurorial dhe për të rritur ndërgjegjësimin publik të shkallës në të cilën sistemi prokurorial promovon qasjen e publikut në shërbimet e drejtësisë.

Sistemi i prokurorisë do të jetë transparent dhe do të komunikojë në mënyrë efektive me anëtarë të mediave dhe publikut (duke përfshirë të gjithë sektorët e shoqërisë së Kosovës), në mënyrë që të promovojë besimin e publikut dhe konfidencën. Në këtë drejtim, KPK do të sigurojë që shërbimi i prokurorisë do të ofron publikut informacion të përshtatshëm në lidhje me ndjekjen penale të rasteve individuale dhe punën e shërbimit të prokurorisë përmes aktiviteteve në terren, mediave dhe aktiviteteve të tjera.

Ky është një objektiv shumë i rëndësishëm sepse vetëdijësimi publik i sistemit të drejtësisë penale dhe prokurorisë mbetet i ulët. Ndërkohë prokurorët individual dhe sistemi prokurorial pranojnë komente negative në shtyp, ka pak mbulim të sukseseve të tyre apo sukseseve të shërbimit të prokurorisë në tërësi. Kjo situatë kontribuon në perceptimin publik të kufizimit në qasjen në drejtësi. Këshilli do të fuqizojë aktivitetet publike në terren për të forcuar besimin e publikut në sistemin prokurorial.

Momentalisht kyçja e publikut në identitetin elektronik të Këshillit bëhet përmes linkut i cili është i postuar në faqen e internetit në zyrën e Prokurorit të Shtetit ndërsa, Kushtetuta dhe Ligjet kërkojnë veprim të pavarur. Në përputhje me këto rrethana, me qëllim të ruajtjes së pavarësisë së vet dhe për të pasur një forum, në të cilën do të informon publikun për qëllime të përgjithshme, por edhe për të përmirësuar besimin e publikut në sistemin prokurorial, Këshilli do të ndërmarrë hapat e mëposhtëm:


3.2. Objektiva strategjike 3.2 *Ofrimi i qasjes së publikut në raporte dhe regjistra lidhur me të dhëna prokuroriale*

Në lidhje me performancën e zyrave prokuroriale dhe prokurorëve, nga Njësia e Vlerësimit të Performancës së KPK-së janë ndërmarrë hapa për të zhvilluar një bazë të dhënash që do të mundësojë kapjen e informacionit të saktë në lidhje me punën e prokurorive dhe prokurorëve.

Njësia e Këshillit të Vlerësimit të Performancës do të vlerësojë mjetet me të cilat mbledh informacion në lidhje me punën e kryer nga ana e shërbimit të prokurorisë, duke përfshirë zyrat prokuroriale. Kjo do të përmirësojë analizën dhe prezantimin e këtij informacioni për të siguruar që pikat kyçe mund të kuptohet lehtë, dhe që performanca është përmirësuar si e përshtatshme.

3.3. Objektiva strategjike 3.3 *Sigurimi i konfidencialitetit të informatave, aty ku kërkohet me ligje të Kosovës*

Në përmbushjen e përgjegjësiave të saj për të rritur qasjen në dokumente publike të krijuara nga Këshilli dhe informacione të tjera, institucioni prokurorial do të ruajë informacionin që është i mbrojtur sipas ligjeve të privatësisë së Kosovës. Përpjekja e komunikimit dhe e transparencës e sistemit të prokurorisë në të njëjtën kohë do të respekton dhe mbrojnë nevojën për intimitet në lidhje me hetimet në vazhdim, si dhe jetën private, shëndetin dhe mirëqenien e dëshmitarëve, viktimave, të pandehurve si dhe prokurorë dhe personave të tjerë të përfshirë. Sipas ligjit, Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Prokurori i Shtetit duhet të mbrojnë sigurinë e të gjitha të dhënave personale për të cilat ka përgjegjësi. Kjo përfshinë të gjitha të dhënat në lidhje me personat e gjallë apo të vdekurve të cilët mund të identifikohen (duke përfshirë dosjet e prokurorisë, të dhënat e personelit, dhe kështu me radhë). Rrjedhimisht, Këshilli do ndërmarrë hapa për të siguruar konfidencialitetin e informatave deri



në atë masë siç kërkohet me Ligje të Kosovës.

3.4. Objektiva strategjike 3.4 *Lehtësim të qasjes në drejtësi nga minoritetet etnike dhe grupet në rrezik*

Kushtetuta pranon se Kosova është një shoqëri shumëgjuhëshe dhe shoqëri shumë-etnike, dhe kjo kërkon trajtim të drejtë të të gjithë individëve. Rrjedhimisht, Këshilli, Zyra e Prokurorit të Shtetit, dhe Zyrat individuale e prokurorisë duhet vazhdimisht të sigurojnë se grupet minoritare kanë qasje të plotë ndaj shërbimeve të ofruara nga sistemi prokurorial. Prandaj, Këshilli do ndërmarrë hapat e duhura për të lehtësuar qasjen në drejtësi nga minoritetet etnike dhe grupet në rrezik.

Shtylla IV: përmirësimi i shërbimeve dhe teknologjisë

Përpyekjet për të ngitur fuqin dhe funksionalitetin e sistemit prokurorial në mënyrë të qartë do të mbështetet nga përmirësimi i infrastrukturës fizike, pajisjet dhe teknologjia informative, përfshirë sistemin e menagjimit të rasteve dhe databazat.

4.1. Objektiva strategjike 4.1 *Themelimi i një infrastrukture adekuate të informimit dhe teknologjisë*

Këshilli e pranon se një infrastrukturë e qëndrueshme, e varshme e teknologjisë informative është çelësi i efikasitetit të funksioneve administrative dhe juridike të sistemit prokurorial. Prandaj, Këshilli do të ndërmarrë hapa të duhur për të themeluar një infrastrukturë të përshtatshme të teknologjisë informative.


4.2. Objektiva strategjike 4.2 *Sigurimi i mjaftueshmërisë së shërbimeve prokuroriale*

Këshilli e pranon se shërbimet funksionale prokuroriale janë çelësi i arritjeve të suksesshme të synimeve dhe objektivave të sistemit prokurorial. Prandaj, KPK do të ndërmarrë hapa të duhur për të siguruar mjaftueshmëri të shërbimeve ekzistuese prokuroriale.

Gjatë periudhës së këtij Plani Strategjik, Prokuroria e Shtetit mund të zhvillojë dhe të lëviz në disa zyre të reja të ndërtesës. Në mënyrë për të siguruar vazhdimësi dhe efikasitet të shërbimeve prokuroriale, Këshilli ka për detyrë të sigurojë që infrastruktura fizike e çfarëdo ndërtese të re apo zyre e Këshillit apo Prokurorit të Shtetit të jetë adekuate. Prandaj, Këshilli do të ndërmarrë hapa të duhur për të siguruar përshtatshmëri të shërbimeve të reja prokuroriale.

4.3. Objektiva strategjike 4.3 *Sigurimi i sigurisë adekuate për prokurorë, personel të prokurorisë, dhe shërbime prokuroriale*

Siguria e të gjithë personave të cilët punojnë në sistemin e prokurorisë është thelbësisht e rëndësishme për Këshillin. Në mënyrë të ngjashme, Këshilli i kushton rëndësi të madhe mbrojtjes së të dhënave konfidenciale, dëshmimeve dhe gjësendeve tjera të cilat gjenden në kujdestari të sistemit prokurorial. Prandaj, Këshilli do të marrë hapa të duhur për të ofruar siguri adekuate për prokurorë, personel të prokurorisë dhe shërbimeve prokuroriale.




Zbatimi dhe Monitorimi i Planit Strategjik

Në analizimin përfundimtar, do të bëhet monitorimi dhe vlerësimi i planeve strategjike dhe të veprimit që do të sigurojë qëndrueshmëri të qëllimeve dhe objektivave strategjike për një afat më të gjatë.


Prandaj, KPK do krijojë dhe plotësojë një pozitë në kuadër të Sekretariatit me kompetencë për të monitoruar progresin drejtë qëllimeve strategjike, dhe do të zhvillojë një protokoll për raportimin e progresit dhe mbikëqyrjen e nivelit të Këshillit që është bërë nga përdorimi i një instrumenti për monitorim dhe vlerësim që siguron caktimin e përgjegjësive specifike të implementimit tek individët e caktuar, rregullimin e afateve specifike kohore dhe afateve, raportimin e progresit dhe tiparet tjera organizative.

KPK-ja do të përdorë matriksin në Shtojcën I për të zhvilluar plane më të detajuara të punës për të arritur secilin qëllim dhe objektivë strategjike duke u bazuar në një udhëzim që do të miratohet nga Këshilli.




SHTOJCA 2: KONSIDERATAT E PLANIT TË VEPRIMIT**TABELA E PËRMBAJTJES**

SHTYLLA I: FUQIZIMI I STRUKTURËS INSTITUCIONALE DHE KAPACITETET E SISTEMIT PROKURORIAL	27
Objektiva strategjike 1.1	
<i>Ngritja e përgjegjësisë financiare dhe përditësimi i procesit buxhetor</i>	27
Objektiva strategjike 1.2	
<i>Krijimi i një procesi të emërimit, përbërjes dhe statusit të KPK-së që është në pajtim me standarde Evropiane</i>	28
Objektiva strategjike 1.3	
<i>Qartësimi i rolit dhe strukturës organizative të Sekretariatit</i>	30
Objektiva strategjike 1.4	
<i>Rritja e planifikimit të politikave</i>	31
Objektiva strategjike 1.5	
<i>Miratim i proceseve që KPK do përdorë për hartimin dhe miratimin e rregulloreve dhe akteve tjera nënligjore</i>	31
Objektiva strategjike 1.6	
<i>Përmirësimi i koordinimit në mes të KPK, Sekretariatit të KPK-së dhe Prokurorive</i>	31
Objektiva strategjike 1.7	
<i>Përmirësimi i koordinimit të veprimeve me organe ndërkombëtare dhe organe tjera kombëtare, si Ministrinë e Drejtësisë, Institutin Gjyqësor të Kosovës, Policinë e Kosovës dhe Odën e Avokatëve</i>	32
SHTYLLA II: PROMOVIMI I KOMPETENCËS DHE PROFESIONALIZMIT	32
Objektiva strategjike 2.1	
<i>Rritja e stabilitetit të mandatit të prokurorëve</i>	32
Objektiva strategjike 2.2	
<i>Themelimi i kriterëve transparente dhe proceseve për rekrutim të prokurorëve, sigurimi i kompetencave të nevojshme profesionale</i>	33
Objektiva strategjike 2.3	
<i>Rishikimi i statusit së prokurorëve dhe personelit të KPK</i>	33
Objektiva strategjike 2.4	
<i>Rritja e diversitetit gjinor dhe etnik në rekrutimin e prokurorëve dhe stafit administrative</i>	34
Objektiva strategjike 2.5	
<i>Themelimi i rrugëve të qarta të karrieres në kuadër të institucionit prokurorial</i>	34
Objektiva strategjike 2.6	
<i>Fuqizimi i menaxhimit dhe planifikimit të burimeve njerëzore</i>	34




Objektiva strategjike 2.7	
<i>Krijimi i standardeve të larta etike për prokurorë dhe personelin mbështetes prokurorial</i>	34
Objektiva strategjike 2.8	
<i>Paraqitja e treguesve matës të performancës për Prokurori (për komponente institucional, prokurorë, dhe poashtu staf mbështetës)</i>	35
Objektiva strategjike 2.9	
<i>Forcimi i procesit të vlerësimit për prokurorë dhe stafë prokurorial</i>	35
Objektiva strategjike 2.10	
<i>Forcimi i sistemit disiplinore për prokurorë dhe stafin prokurorial</i>	36
Objektiva strategjike 2.11	
<i>Dispozita për trajnime specifike për prokurorë</i>	38
Objektiva strategjike 2.12	
<i>Dispozita për trajnime të përbashkëta për prokurorë dhe stafin administrativë</i>	38
SHTYLLA III: RRRITJA E AKTIVITETEVE NË TERREN DHE MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN	39
Objektiva strategjike 3.1	
<i>Promovimi i besimit të publikut në sistemin prokurorial përmes aktiviteteve publike në terren</i>	39
Objektiva strategjike 3.2	
<i>Sigurimi i qasjes publike në raporte dhe dosje lidhur më të dhënat prokuroriale</i>	41
Objektiva strategjike 3.3	
<i>Sigurimi i konfidencialitetit të informatave, aty ku kërkohet me Ligje të Kosovës</i>	41
Objektiva strategjike 3.4	
<i>Mundësimi i qasjes në drejtësi të minoriteteve etnike dhe grupeve në rrezik</i>	41
SHTYLLA IV: PËRMIRËSIMI I OBJEKTEVE DHE TEKNOLOGJISË	41
Objektiva strategjike 4.1	
<i>Themelimi i një infrastrukture adekuate të teknologjisë informative</i>	41
Objektiva strategjike 4.2	
<i>Sigurimi i mjaftueshmërisë së objekteve prokuroriale</i>	41
Objektiva strategjike 4.3	
<i>Sigurimi i sigurisë adekuate për prokurorë, personelin e prokurorive dhe objekteve prokuroriale</i>	42



Shtylla I: Fuqizimi i strukturës institucionale dhe kapacitetet e sistemit prokurorial

Objektiva strategjike 1.1 Ngritja e përgjegjësisë institucionale dhe përditësimi i procesit buxhetor

- Në pajtim me Nenin 13 të Ligjit me ndryshime dhe plotësime, Këshilli do të krijojë të gjithë mekanizmat e përshtatshëm për menaxhimin e përgjegjësive të tij për përgatitjen dhe dorëzimin e draft buxhetit vjetor për shqyrtim dhe miratim nga Kuvendi dhe më pas për administrimin e buxhetit, duke përfshirë mbikëqyrjen e shpenzimeve, alokimin e fondeve, mirëmbajtjen e saktë dhe azhurnimin e llogarive dhe auditimet financiare.
- Këshilli do të kërkojë delegimin e autoritetit për të administruar buxhetin e Zyrës së Prokurorit Disiplinor të Sekretariatit të ZPD, dhe për të shqyrtuar e miratuar delegimet e brendshme financiare të KPK-së si një Organizatë Buxhetore.
- Këshilli do të përmirësojë qarkullimin e rregulloreve të brendshme buxhetore dhe oraret në Prokurori, Departamentet dhe Njësitë mbi të cilat menaxheri i financave mbështetet për informacion të detajuar të buxhetit, e që është konsoliduar më pas në buxhetin e KPK-së nga ana e Sekretariatit. Për më tepër, Këshilli do të zhvillojë procedura standarde operative për aspektet relevante të procesit të përcaktimit të buxhetit, të tilla si përcaktimi i qëllimeve, objektivave, dhe treguesve të performancës. Së fundi, Këshilli do të sigurojë që vlerësimi i nevojave për trajnim realizohet në këtë aspekt, dhe se trajnimi i duhur është kryer.
- Këshilli do të vendosë një mekanizëm që do të sigurojë monitorim të vazhdueshëm buxhetor dhe për të rritur kapacitetin për raportimin financiar tremujor dhe vjetor. Ai gjithashtu do të përmirësojë përmbajtjen e prezantimit të buxhetit, si dhe procesin e paraqitjes së raporteve financiare në Komisionin e KPK-së për Buxhet dhe Financa. Për më tepër, Këshilli do të punojë për të rritur vetëdijen dhe rëndësinë e përmbajtjes së raportit të revizionit (auditimit), çështjet materiale që dalin për shqyrtim në nivel të Bordit dhe veprim të duhur, si dhe të zhvillojë veprimet e nevojshme përcjellëse bazuar në gjetjet e auditimit, siç janë raportet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe të auditorëve të brendshëm.
- Këshilli do të rrisë ndërgjegjësimin dhe të kuptuarit e anëtarëve të tij, si dhe anëtarëve të Komisionit të Buxhetit dhe Financave të KPK, në lidhje me përgjegjësinë e tyre për të siguruar se nuk ka përgjegjshmëri për ngritjen, miratimin, monitorimin dhe mbikëqyrjen e buxhetit të KPK-së. Komisioni për Buxhet dhe Financa i KPK-së do të përmirësojë planifikimin paraprak të pikave të agjendës së Këshillit me fokus të veçantë në orarin e procesit të përcaktimit të buxhetit vjetor, rishikimin buxhetor në mes të vitit, prezantimin e shifrave të realizuara, si dhe shqyrtimin dhe përgjigjet në gjetjet e raportit të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm.
- Këshilli do të ndërmarrë hapa për ndërtimin e kapaciteteve të menaxherëve jo-financiarë që ofrojnë të dhëna financiare për planifikimin, zbatimin, dhe procesin e monitorimit të buxhetit në mënyrë që të përmirësojë efektivitetin dhe efikasitetin e atij procesi. Në mënyrë të ngjashme, Këshilli do të ndërmarrë hapa për të ndërtuar kapacitetet e zyrtarëve financiarë në prokurori në mënyrë që të bëjnë planifikimin, ekzekutimin, dhe procesin e monitorimit të buxhetit të KPK-së.
- Këshilli do të zhvillojë dhe miratojë procedurat standarde të veprimit lidhur me dokumentet




specifike që nevojitet si pjesë e procesit të caktimit të buxhetit që do të përfshijë, për shembull, qëllimet, synimet specifike dhe treguesit e performancës.


- Këshilli do të ndërmarrë hapa për të përmirësuar përmbajtjen e paraqitjes së buxhetit si dhe procesin për paraqitjen e raporteve financiare tek Komisioni i KPK-së për Buxhet & Financa.
- Këshilli do të kryejë vlerësime periodike të efikasitetit të kontrolleve buxhetore dhe të prokurimit, përfshirë ato lidhur me të gjeturat dhe rekomandimet e pasqyruara në raportet e përgatitura nga Auditori i Përgjithshëm.
- Këshilli do të zhvillojë, monitorojë dhe bëjë rishikimet e nevojshme në strategji për kontrollet buxhetore dhe të prokurimit që do të jenë në përputhje me të gjeturat dhe rekomandimet e pasqyruara në raportet e përgatitura nga Auditori i Përgjithshëm.
- Këshilli do të ndërmarrë hapa për të shtuar vetëdijen dhe rëndësinë e përmbajtjes së raportit të auditimit si dhe do të krijojë një proces për të adresuar çështjet materiale që kërkojnë shqyrtim në nivel të Bordit, veprim dhe përcjellje që rezulton nga të gjeturat e auditimit nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm dhe auditorët e brendshëm.

Objektiva strategjike 1.2 Krijimi i një procesi të emërimit, përbërjes dhe statusit të KPK-së që është në pajtim me standarde Evropiane

- Këshilli do të ndërmarrë të gjithë hapat sipas dispozitave të Ligjit për ndryshim dhe plotësim që ndërlidhen me procesin e emërimit, përbërjen dhe statusin e KPK-së, duke përfshirë, ndër tjera, Nenin 5, 5A, 10, 14 dhe 14A.
- Të përgatisë dokument paraprak për dorëzim në Ministrinë e Drejtësisë që mbështet rekomandimin për ndryshimin e Ligjit për KPK-së për të krijuar pozitën e Zëvendës kryesuesit të Këshillit, me një përshkrim të përgjegjësive të veçanta të Zëvendës kryesuesit.
- Këshilli do të mirëmbajë dhe do të vazhdojë të publikojë në internet strukturën e tanishme të veçantë që reflekton pavarësinë e KPK-së nga ZPSH-ja.
- Këshilli do të monitorojë dhe do të vazhdojë të përmirësojë strukturën e tij të brendshme duke zhvilluar më tutje Komisionin për Buxhet, Financa dhe Personel, sipas nevojës:
 - ✓ Zhvilluar më tutje Komisionin për Buxhet, Financa dhe Personel, sipas nevojës.
 - ✓ Zhvilluar më tutje Komisionin për Çështje Normative, sipas nevojës.
 - ✓ Zhvillojë më tutje Komisionin për Administrimin e Prokurorive, sipas nevojës;
 - ✓ Zhvillojë më tutje Komisionin Disiplinor, sipas nevojës;
 - ✓ Zhvillojë më tutje Komisionin për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve, sipas nevojës;
 - ✓ Krijuar komisione të tjera të përhershme dhe *ad hoc* sipas nevojës për të përmirësuar punën e saj.
 - ✓ Siguruar që ekzistenca dhe kompetencat e komisioneve të Këshillit do të kenë një bazë në ligj, me fleksibilitet për të krijuar komisione të përhershme dhe *ad hoc* sipas nevojës.
- Me përjashtim të Komisionit Disiplinor, Këshilli do të sigurojë që asnjë komision mos të ketë fuqi vendimtare, dhe se do të kërkohet nga të gjitha komisionet ti japin Këshillit raport shpjegues dhe dokumentacione tjera duke mbështetur vendimin e rekomanduar nga Komisioni.



- Për të mbrojtur integritetin, efikasitetin, dhe efektivitetin e komisioneve të Këshillit, Këshilli do të përgatisë një dokument paraprak për dorëzim në Ministrinë e Drejtësisë i cili mbështet rekomandimin e një amendamenti në Ligjin për KPK-në ose ndërmarrjen e hapave të tjerë që do të reflektojnë rregullat bazë për përbërjen e komisioneve, dhe që do të sigurojnë:
 - ✓ Mundësimin e pjesëmarrjes së një numri mjaftueshmërisht të lartë të anëtarëve të komisionit për të lejuar një diskutim të gjerë, por një numër mjaft të ulët të anëtarëve për të lejuar punë të qetë.
 - ✓ Përcaktimin se nëse përfaqësuesit e profesioneve të tjera janë anëtarë të një komisioni, numri i prokurorëve në komision duhet të jetë një shumicë.
 - ✓ Përcaktimin e disa rregullave themelore të procedurës së komisionit, të tilla si kuorum, hedhje e votës, zgjidhje për situatat në të cilat ka vota të barabarta, dhe kështu me radhë.
 - ✓ Ndalimi i Kryesuesit të KPK-së që të shërbejë në ndonjë komision për shkak të natyrës së detyrave të Kryesuesit.
- Këshilli do të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për të siguruar që anëtarët e komisionit janë të liruar nga detyra të tjera në atë masë që është e nevojshme në mënyrë që përgjegjësia për të përgatitur projekt-vendime dhe të angazhohen në diskutime në lidhje me punën e komisionit. Në veçanti, do të përdoret një parim rotacioni për përbërjen e Komisionit Disiplinor, dhe do të përdoret një sistem i alternuar i raportimit në mënyrë që të ndahet ngarkesa e punës.
- Të bëhet një vlerësim i nevojave për të përcaktuar numrin minimal të personelit ndihmës të nevojshëm për të mbështetur Këshillin, dhe në lidhje me përmirësimet tjera të nevojshme për mbështetjen e pjesëtarëve të KPK-së.
- Të bëhet një vlerësim i nevojave për ofrim të trajnimit të duhur për të ndihmuar pjesëtarët e KPK-së në kryerjen e detyrës së mbikëqyrjes dhe përgjegjësi të tjera. Këshilli do të përgatisë planet e trajnimit si të dobishme dhe do të zbatojë trajnim të duhur për pjesëtarët e KPK-së. Këshilli do të themelojë një Komision ad hoc të Trajnimit, i cili do të koordinohet me Institutin Gjyqësor të Kosovës për të kryer përgjegjësitë specifike të këtij funksioni.
- Rritja e aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve në mënyrë që të përgatisin anëtarët e stafit mbështetës për ofrimin e ndihmës së përgjegjshme, profesionale, dhe efikase në funksionimin e Këshillit. Veçanërisht vëmendje do t'i kushtohet ngritjes së kapaciteteve të sekretarëve juridik të caktuar për Komisionet, si dhe kryetarët e njësive dhe zyra në Sekretariat dhe Njësinë e Vlerësimit dhe të Performancës, duke përfshirë në lidhje me (a) krijimin e dokumentacionit të duhur të gjitha vendimeve, duke përfshirë indeksimin, (b) mirëmbajtjen e dosjeve dhe komunikimit me palët në punën e KPK-së, (c) duke siguruar zbatimin e unifikuar të ligjit, dhe (d) përmirësimin e kapacitetit kërkimor ligjor të Këshillit. Në këtë drejtim, Këshilli gjithashtu do të sigurojë trajnim të vazhdueshëm të përbashkët për të mbështetur anëtarët e stafit në lidhje me rekrutimin, vlerësimin, dhe aktivitetet disiplinore të KPK-së dhe komisioneve të tij, si dhe çështjeve të tjera që do të sigurojnë një kuptim të plotë të rolit të stafit mbështetës në këto procese, të cilat do të kryhen në mënyrë që të krijojnë një ambient bashkëpunues të koordinuar që do të lehtësojë arritjen e objektivave institucionale.
- Këshilli do të miratojë dhe do të ndjekë planet vjetore të punës, planet e veprimit, si




dhe dokumentet e tjera të planifikimit për të arritur rezultatet në këtë Plan Strategjik. Në veçanti, Këshilli do të sigurojë që planet e punës vjetore, planet e veprimit, dhe planet e tjera të punës janë në sinkronizim me Planin Strategjik në mënyrë që të gjitha përpjekjet janë të drejtuara në drejtim të realizimit të qëllimeve dhe objektivave që janë vlerësuar si prioritete nga procesi i diskutimit që rezultoi në miratim të Planit Strategjik.

- Këshilli do të vendosë një proces të monitorimit dhe vlerësimit për të siguruar përmbushjen e qëllimeve të përcaktuara nga planet e punës, planet strategjike, si dhe dokumentet tjera të planifikimit, të cilat do të përfshijnë punësimin e një specialisti i cili do të koordinojë materialet e monitorimit dhe vlerësimit. Koordinatori i monitorimit dhe vlerësimit ndër të tjera, do të marrë parasysh raportet, në bazë të një orari të caktuar, nga Njësia e Vlerësimit të Performancës së KPK-së, Komisioneve të KPK-së, si dhe mekanizmave të tjerë dhe burimeve të informatave në mënyrë që të ndihmojë Këshillin në kryerjen e shqyrtimeve të tij që janë kryer në bazë të provave. Si shembuj, çështjet e këtyre aktiviteteve do të përfshijnë:
 - ✓ Përditësimin nga Komisionit për Buxhet.
 - ✓ Funkcionimin e Regjistrave të Prokurorisë.
 - ✓ Progresin në arritjen e Objektivave të Planit Strategjik në Bashkëpunim Ndërinstitucional në Luftën kundër Krimit të Organizuar.
 - ✓ Progresin drejt përmbushjes së angazhimeve të tij sipas Strategjisë Kombëtare të Anti-Korrupsionit dhe Planit të Veprimit.
 - ✓ Progresin në arritjen e objektivave të këtij Plani Strategjik.
 - ✓ Raportet tjera sipas nevojës.
- KPK-ja do të marrë parasysh potencialin për përmirësimin e efikasitetit të Këshillit përmes mbështetjes në seancat më pak të shpeshta dhe/ose më të gjata.

Objektiva strategjike 1.3 Qartësimi i rolit dhe strukturës organizative të Sekretariatit

- Këshilli do të zbatojë Nenet 14 dhe 14A të Ligjit me ndryshime dhe plotësime lidhur me themelimin e Sekretariatit të Këshillit dhe emërimin e Drejtorit të Sekretariatit të KPK.
- Këshilli do të theksojë pavarësinë e tij institucionale gjatë ushtrimit të përgjegjësisë së tij për mbikëqyrjen e Zyrës së Prokurorit të Shtetit, dhe në lidhje me këtë do të bëjë ndonjë ndryshim nëse është e nevojshme për të siguruar pavarësinë e Këshillit, dhe për të treguar atë pavarësi përmes publikimit të një strukture organizative të veçantë të kornizës së Këshillit.
- Këshilli do të kryej një studim për decentralizimin e menaxhimit për të përcaktuar se cila, nëse ka, detyra të Sekretariatit duhet të transferohen, ose të ndahen me Zyrat individuale të Prokurorisë në mënyrë që të përmirësohet efikasiteti në administrimin e sistemit prokurorial.
- Bazuar në rezultatet e studimit të decentralizimit, Këshilli do të miratojë ndryshime të tilla në procedurat e menaxhimit siç janë të justifikuar nga studimi.
- Këshilli do të sigurohet që prokurorët dhe personeli ndihmës i prekur nga çdo vendim i decentralizimit të trajnohen në lidhje me strukturën e re, veçanërisht duke përfshirë funksionet e buxhetit dhe financave, të cilat do të dizajnohen për të ruajtur efikasitetin maksimal.



Objektiva strategjike 1.4 Rritja e planifikimit të politikave


- Këshilli do të themelojë një zyrë të Planifikimit Strategjik, ose, të paktën, të caktojë zyrtarë për të kryer hulumtime të politikave, të kryejë mbështetje të planifikimit për Këshillin, dhe për të ndihmuar në përmirësimin e administratës për praktikën më të mira prokuroriale.

Objektiva strategjike 1.5 Miratim i proceseve që KPK do përdorë për hartimin dhe miratimin e rregulloreve dhe akteve tjera nënligjore

- Këshilli do të përgatisë një koncept dokument për dorëzim në Ministrinë e Drejtësisë duke mbështetur rekomandimin për amendamentimin e ligjeve përkatëse dhe, sipas nevojës edhe Kushtetutës, në mënyrë që ajo të arrijë stabilitetin e infrastrukturës së saj, duke përfshirë konsideratat e cekura më poshtë:
 - ✓ Domosdoshmërinë e një amendamenti kushtetues, amendamenti ligjor, ose interpretimi ligjor që do të sqaronte pushtetin e Këshillit për të nxjerrë rregulla, dhe të jep autoritet në Gjykatën Kushtetuese për shqyrtimin e rregulloreve të tilla sepse duket se Kushtetuta aktualisht parashikon vetëm shqyrtimet e rregulloret e nxjerra nga dega e ekzekutivit.
 - ✓ Këshilli do të përgatisë një dokument paraprak për dorëzim në Ministrinë e Drejtësisë duke mbështetur rekomandimin që Ligji për KPK-në të ndryshohet për të përshkruar në mënyrë specifike llojet e akteve normative që Këshilli është i autorizuar të nxjerrë, duke përfshirë rregulloret (ndryshimet në rregulloret), vendime (të drejtuara nga një apo më shumë individ), dhe udhëzimet (duke përfshirë udhëzimet e përgjithshme ose qarkore të drejtuara në një ose më shumë individë).
 - ✓ Këshilli do të përgatisë një koncept dokument për dorëzim në Ministrinë e Drejtësisë duke mbështetur rekomandimin që Ligji për KPK-në, në mënyrë eksplicite të identifikoj se ku vendimet publike, apo dokumente të tjera publike, të KPK-së duhet të publikohen. Brenda fushëveprimit të kompetencave të veta, Këshilli do të miratojë një rregull në lidhje me publikimin e vendimeve të KPK-së në qoftë se Ligji për KPK-së nuk ndryshohet në mënyrë që të kërkojë publikim.
- Brenda fushëveprimit të kompetencave të veta, Këshilli do të miratojë një rregull në lidhje me publikimin e vendimeve të KPK-së në qoftë se Ligji për KPK-në nuk ndryshohet në mënyrë që të kërkojë publikim.
- Brenda fushëveprimit të kompetencave të veta, Këshilli do të miratojë një rregull që do të referohet në rregulloret dhe vendimet në datën e publikimit, si datën në të cilën akti përkatës hyn në fuqi, dhe në dokumentet e tilla gjithashtu do të specifikohet data e publikimit.

Objektiva strategjike 1.6 Përmirësimi i koordinimit në mes të KPK, Sekretariatit të KPK-së dhe Prokurorive

- Këshilli do të sigurojë që mekanizmi ekzistues për komunikim të brendshëm të vlerësohet, se nevojat për komunikim të vlerësohen, dhe që të merren hapa për të përmirësuar komunikimin ekzistues të brendshëm. Kjo do të përfshijë përgatitjen dhe zbatimin e planit të komunikimit të brendshëm apo strategjisë. Këto hapa duhet të sigurojnë që të gjithë personat që punojnë në kuadër të shërbimit të prokurorisë kanë qasje në gjuhët e tyre për informacionet që iu nevojitet për të kryer detyrat e tyre në mënyrë profesionale, efektive dhe efikase, dhe janë të vetëdijshëm për zhvillimet kryesore që ndikojnë në punën e tyre.




Objektiva strategjike 1.7 Përmirësimi i koordimit të veprimeve me organe ndërkombëtare dhe organe tjera kombëtare, si Ministrinë e Drejtësisë, Institutin Gjyqësor të Kosovës, Policinë e Kosovës dhe Odën e Avokatëve

- Pa kompromentuar pavarësinë e gjyqësorit nga funksionet e sistemit të prokurorisë, Këshilli do të përgatisë një koncept dokument për dorëzim në Ministrinë e Drejtësisë i cili mbështet një rekomandim që Ligjet për KPK-në dhe KGJK-në të ndryshohen për të vendosur një mekanizëm ndër-Këshillues të koordinimit dhe bashkëpunimit në mënyrë që të përmirësojë ndërveprimin ndërmjet KGJK-së dhe KPK-së, të cilat mund të përfshijnë vëzhgimet e aktiviteteve të Këshillit nga një anëtar i Këshillit përkatës, takime të detyrueshme të rregullta mes Drejtorëve përkatës të Sekretariatit dhe shefave të departamenteve.
- Për aq sa është e nevojshme, Këshilli do të përmirësojë ndërlidhjen e tij me Ministrinë e Drejtësisë për shkak se ajo është e nevojshme për të siguruar që ligjet që ndikojnë në sistemin prokurorial janë propozuar ose rishikuar në mënyrë që çështjet relevante janë zgjidhur.
- Këshilli do të vazhdojë të bashkëpunojë ngushtë me Institutin Gjyqësor të Kosovës në mënyrë që të përmbushë detyrimin e tij mbikëqyrës për të siguruar që përpjekjet e trajnimit arrijnë pritjet profesionale të këtij Plani Strategjik.
- Për sa kohë që pjesëtarët e stafit mbështetës të sistemit prokurorial janë punonjës të Ministrisë së Administratës Publike, Këshilli do të bashkëpunojë ngushtë me zyrën e trajnimit të MAP-it në mënyrë që të përmbushë detyrimin e tij të mbikëqyrjes për të siguruar që përpjekjet e trajnimit përmbushin pritjet profesionale të këtij Plani Strategjik. Përveç kësaj, në qoftë se pjesëtarët e stafit mbështetës të sistemit prokurorial bëhen punonjës të sistemit të prokurorisë, Këshilli do të bashkëpunojë me zyrat e dhura në mënyrë që të vazhdojë të përmbushë detyrimin e tij të mbikëqyrjes për të siguruar që përpjekjet e trajnimit përmbushin pritjet profesionale të këtij Plani Strategjik.
- Për aq sa është e nevojshme, Këshilli do të përmirësojë ndërlidhjen e tij me Policinë e Kosovës sepse PK-ja mbështet ndjekjet penale të kryera nga sistemi prokurorial, dhe ndërlidhja e tillë është e nevojshme për të siguruar që ndjekjet penale janë efektive dhe efektive.
- Për aq sa është e nevojshme, Këshilli do të përmirësojë bashkëpunimin me Odën e Avokatëve për të ruajtur rregullat efektive dhe efektive, procedurat, dhe aktivitetet e tjera që lidhen me administrimin e drejtësisë.

Shtylla II: Promovimi i kompetencës dhe profesionalizmit

Objektiva strategjike 2.1 Rritja e stabilitetit të mandatit të prokurorëve

- Përgatitja e koncept dokumentit për dorëzim në Ministrinë e Drejtësisë me të cilin mbështetet amendamenti në Ligjin për KPK-në që do të caktojë fuqinë e pranimit të kandidatëve prokuror në fazën fillestare të punësimit në Këshill.
- Nëse, pas monitorimit të situatës, Këshilli konstaton se ka probleme me këtë procedurë, do të paraqesë një koncept dokument në Ministrinë e Drejtësisë i cili do të mbështesë një amendament të Kushtetutës që do të futë masa shtesë, duke përfshirë ndoshta një kërkesë



të shkruar dhe vendime të arsyetuara, dhe një e drejtë për shqyrtim gjyqësor të vendimeve të mos-riemërimit.


- Në ndërkohë, Këshilli do të dorëzojë një koncept dokument në Ministrinë Drejtësisë në mbështetje të një amendamenti të Ligjit për KPK-në që do të krijojë një procedurë administrative të ankimit për vendime të mos-riemërimit.

Objektiva strategjike 2.2 *Themelimi i kritereve transparente dhe proceseve për rekrutim të prokurorëve, sigurimi i kompetencave të nevojshme profesionale*

- Këshilli do të zhvillojë dhe zbatojë një qasje pro-aktive dhe bazuara në merita të rekrutimit të dizajnuara për të gjetur dhe të emëruar një fuqi punëtore që përpiqet për të arritur përsosmërinë dhe për të përmbushur standarde të larta të sjelljes etike.
- Këshilli do të përgatisë një dokument paraprak që do të mbështesë ndryshimet në Ligjin mbi KPK-në, sigurimin për shfrytëzimin e një trajnimi, provimi, dhe procesi të mentorimit që do të përdoret gjatë periudhës fillestare të trajnimit të kandidatëve të prokurorëve që do të promovojnë përsosmërinë e performancës.
- Këshilli do të përdorë një proces të rekrutimit që është i qartë dhe transparent.
- Këshilli do të sigurojë marrjen në punë të një fuqie punëtore që përfaqëson dallimet etnike dhe gjinore të Kosovës.
- Këshilli do të përgatisë një dokument paraprak për dorëzim në Ministrinë e Drejtësisë duke mbështetur rekomandimin që Ligji për KPK-në të ndryshohet në mënyrë që KPK-ja të ketë kompetenca për përcaktimin e numrit të prokurorëve të cilët do të jenë të pranuar në trajnimin fillestar.
- Këshilli do të përgatisë një dokument paraprak për dorëzim në Ministrinë e Drejtësisë duke mbështetur rekomandimin që Ligji për KPK-në të ndryshohet në mënyrë që të specifikojnë kriteret për pranim të kandidatëve për trajnim fillestar për prokurorë, e cila duhet të përfshijë konkurrimin, me shkrim, dhe provimet anonime, si dhe burime tjera të informatave (të tilla si rezultatet e provimeve dhe vlerësimeve të mëparshme).
- Këshilli do të përgatisë një dokument paraprak për dorëzim në Ministrinë e Drejtësisë duke mbështetur rekomandimin që Ligji për KPK-në të ndryshohet në mënyrë që të sigurojë një proces për pranim të kandidatëve për trajnim fillestar që do të tregojnë se të trajnuarit do të kenë një probabilitet të lartë të emërimit të fundit si prokurorë.

Objektiva strategjike 2.3 *Rishikimi i statusit të prokurorëve dhe personelit të KPK-së*

- Këshilli do të paraqesë një koncept dokument që ofron një justifikim për ndryshimin e statusit të anëtarëve të stafit mbështetës të institucionit të prokurorisë, duke përfshirë Këshillin, nga nëpunësit civil të punonjësve të Këshillit ose të Zyrës së Prokurorit të Shtetit, sipas rastit.
- Këshilli do të paraqesë një koncept dokument për dorëzim në Ministrinë e Drejtësisë i cili mbështet një rekomandim për një ndryshim në ligjet përkatëse në mënyrë që të mund të realizohet ndryshimi i statusit të punësimit të anëtarëve të stafit mbështetës.
- Këshilli do të përfshijë bazën e ndryshimit të tij të propozuar të statusit të punësimit të anëtarëve të stafit mbështetës në raportin e tij vjetor në Kuvend.



Objektiva strategjike 2.4 *Rritja e diversitetit gjinor dhe etnik në rekrutimin e prokurorëve dhe stafit administrativ*

- Këshilli do të zhvillojë dhe zbatojë një strategji transparente, proaktive të rekrutimit që është i dedikuar për të gjetur dhe punësuar një fuqi punëtore të shumëllojshme që është në përputhje me objektivat kushtetuese dhe statusore. Strategjia do të përfaqësojë një qasje proaktive dhe bazuar në meritat për rekrutim, e dizajnuar për të gjetur dhe punësuar një fuqi punëtore që do të luftojë për të arritur përsosmëri individuale dhe institucionale, dhe për të përmbushur standardet e larta të sjelljes etike, dhe me qëllim që të përputhet me qëllimet multi etnike, diverse të përcaktuara me Kushtetutë.
- Këshilli do të vlerësojë periodikisht produktivitetin e përpjekjeve të tij të rekrutimit dhe do të bëjë rregullime të tilla për strategjinë e tij që mund të jenë të nevojshme për të rritur në maksimum një rezultat të dobishëm.

Objektiva strategjike 2.5 *Themelimi i rrugëve të qarta të karrieres në kuadër të institucionit prokurorial*


- Këshilli do të konsiderojë nevojat e shërbimit të prokurorisë dhe qëllimet e zhvillimit të karrierës të shërbimit punonjës të prokurorisë dhe do të miratojë një strategji të përgjithshme të zhvillimit të karrierës duke e rishikuar planin kur shërbimi i prokurorisë ka nevojë për ndryshim. Plani do të përfshijë planifikimin e vazhdueshëm dhe trajnimin e tërthortë.
- Këshilli do të sigurojë që strategjia e zhvillimit të karrierës do të monitorohet dhe se strategjia do të rishikohet varësisht nga nevojat e institucioneve.

Objektiva strategjike 2.6 *Fuqizimi i menaxhimit dhe planifikimit të burimeve njerëzore*

- KPK-ja do të zhvillojë dhe zbatojë sistemet e menaxhimit të informacionit për të identifikuar nevojat afat-shkurtëra dhe afatgjata të burimeve njerëzore për çdo zyre prokuroriale, dhe KPK-ja do të shqyrtojë këto nevoja në baza të rregullta.
- Si pjesë e procesit të planifikimit të vazhdimësisë, Këshilli do të zbatojë dhe, nëse është e nevojshme, përgatisë një koncept dokument që do të mbështetë amendamentet e Ligjit për KPK-në që parashikon zbatimin e rregullave të qarta në lidhje me daljen në pension, procedurat e mbledhjes së informacioneve në lidhje me daljen në pension dhe datat fundit të mandatit, një politikë të qartë mbi njoftime të vendeve të lira, dhe parashikimin e nevojave për trajnim, veçanërisht në ato afatgjate..
- Këshilli do të zhvillojë dhe zbatojë sistemet e informacionit të menaxhimit për të mundësuar identifikimin e nevojave të burimeve njerëzore për çdo prokurori (prokurorë dhe personel ndihmës) dhe për të rishikuar këto nevoja në baza të rregullta.

Objektiva strategjike 2.7 *Krijimi i standardeve të larta etike për prokurorë dhe personelin mbështetës prokurorial*

- Këshilli do të ndërmarrë hapa për të siguruar që anëtarët e KPK-së, dhe të gjithë personat që punojnë në kuadër të shërbimit të KPK-së dhe prokurorisë, janë plotësisht të vetëdijshëm për detyrimet e tyre etike në bazë të kodeve dhe ligjeve, me anë të programeve gjithëpërfshirëse të trajnimit (përfshirë trajnimin hyrës për anëtarët e rinj të Këshillit,



prokurorët dhe punonjësit e stafit mbështetës).


- Këshilli do të marrë hapa për të siguruar që të gjithë personat që punojnë në shërbimin e prokurorisë janë në gjendje për të marrë këshilla neutrale dhe profesionale në qoftë se ata përballen me dilemat etike. Hapat e tillë mund të përfshijnë këshilltarë të etikës, ofrimin e informacionit përmes burimeve në rrjet të drejtpërdrejtë rreth vendimeve etike të arritura në rastet disiplinore apo hapa të tjerë.
- Këshilli do të vlerësojë periodikisht efektivitetin e qasjes së tij ndaj qëllimeve të llogaridhënies, dhe do të bëjë përmirësime të tilla që mund të jenë të nevojshme për të arritur një rezultat të dobishëm.

Objektiva strategjike 2.8 *Paraqitja e treguesve matës të performancës për Prokurori (për komponentët institucionale, prokurorë, dhe po ashtu staf mbështetës)*

- Këshilli do të zbatojë kërkesat e Nenit 14B të Ligjit me ndryshime dhe plotësime lidhur me krijimin e Komisionit për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve, duke përfshirë kriteret dhe metodat që përdoren nga ky komision për vlerësimin e prokurorëve për qëllime të ngritjes në pozitë, uljes në pozitë ose shkarkimit të prokurorëve.
- Këshilli do të zbatojë kërkesat e Nenit 21.4 dhe 21.5 të Ligjit me ndryshime dhe plotësime, që autorizon Këshillin që të miratojë një rregullore që përcakton standardet e performancës që do të përdoren gjatë kryerjes së vlerësimeve periodike të performancës së prokurorëve gjatë mandatit të tyre fillestar.
- Këshilli do të shqyrtojë standardet e tij të performancës për punonjësit individual, dhe pastaj të bëjë rregullimet e duhura për të siguruar që standardet ofrojnë udhëzime të rëndësishme për punonjësit.
- Këshilli do të sigurojë që standardet e performancës janë të sinkronizuara me objektivat gjithëpërfshirëse të planit strategjik të institucionit.
- Këshilli do të vlerësojë periodikisht efektivitetin dhe qasjen e standardeve të performancës në krahasim me qëllimet e tyre, dhe të bëjë rregullime të tilla për strategjinë e tij që mund të jenë të nevojshme për të maksimalizuar një rezultat të dobishëm.
- Këshilli do të shqyrtojë standardet e veta të performancës për njësitë e institucionit, dhe pastaj të bëjë rregullimet e duhura për të siguruar që standardet ofrojnë udhëzime të rëndësishme për punonjësin.
- Për shkak se NJSHPP ka një rol të rëndësishëm në vlerësimin e performancës së komponentëve të sistemit prokurorial, Këshilli do të sigurojë që standardet e performancës të sigurojnë një bazë të besueshme për matjen e progresit të secilit komponent institucional drejt arritjes së qëllimeve dhe objektivave strategjike.

Objektiva strategjike 2.9 *Forcimi i procesit të vlerësimit për prokurorë dhe staf prokurorial*


- Vlerësimi i Prokurorive. Përpjekja monitoruese dhe vlerësuese e Këshillit lidhur me prokuroritë do të ketë se paku tre elemente:
 - ✓ Në atë shkallë sa paraqitet nevoja, Këshilli do të sigurojë që Kryeprokurorët të përmirësojnë kapacitetin e tyre për të bërë raporte të dobishme lidhur me performancën e prokurorisë së tyre përkatëse në intervale të rregullta dhe të propozojnë përmirësime



- për konsideratën e Këshillit.
- ✓ Njësiti për Vlerësimin e Performancës do të kryejë vlerësimet e prokurorive ashtu siç është kërkuar nga KPK-ja për të monitoruar përparimin e prokurorisë në raport me Planin Strategjik dhe në përgjithësi në mënyrë që Këshilli mund të vlerësojë raportet e Kryeprokurorëve dhe të ndihmojë Këshillin në shqyrtimet përkatëse.
 - ✓ Këshilli do të ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të ngritur kapacitetin e tij për të monitoruar dhe vlerësuar prokuroritë duke përdorur mjete efektive dhe aftësinë e vet për të diskutuar lidhur me aktivitetet e duhura përcjellëse lidhur me të gjeturat sa i përket prokurorive. Përveç kësaj, Këshilli do të miratojë një mekanizëm që do të mundësojë që Këshilli të përcjell përparimin në zgjidhjen e problemeve që janë identifikuar gjatë aktiviteteve të monitorimit dhe vlerësimit dhe të përshëndes sukseset e arritura nga prokuroritë.
 - Vlerësimi i Prokurorëve Individual. Këshilli do të ndërmarrë hapa për të siguruar kryerjen e duhur të vlerësimit të performancës së të gjithë prokurorëve që punojnë në prokurori që do të përfshijë konsideratat për pavarësi, integritet dhe paanshmëri, mes faktorëve tjerë. Duke bërë kështu, Këshilli do të ketë parasysh grupet e ndryshme të njerëzve që punojnë në prokurori. KPK-ja është përgjegjëse për zhvillimin e sistemeve të vlerësimit të performancës për prokurorë dhe Kryeprokurorë (Neni 21 i Ligjit për KPK-në), që duhet të ofrojë sigurimin e paanshmërisë dhe pavarësisë nga ndikimet e jashtme.
 - Vlerësimet e Stafit Mbështetës. Këshilli gjithashtu është përgjegjës për mbikëqyrjen e administrimit të secilës prokurori dhe personelit të tyre për të siguruar që vlerësimet e performancës së stafit të shërbimit civil kryhen në atë mënyrë që i kontribuon objektivave strategjike të KPK-së.
 - Rishikimi i standardeve ekzistuese të performancës për individët, dhe të bëhen përshtatjet e duhura për të siguruar që standardet janë të dizajnuara për të arritur objektivat e këtij Plani dhe se ato do të ofrojnë udhëzim përkatës për prokurorë dhe punonjësit e stafit mbështetës.
 - Pas kësaj, Këshilli periodikisht do të vlerësojë efikasitetin e sistemit të tij të vlerësimit të performancës dhe të ndonjë standardi të performancës dhe do të bëjë rregullimet e nevojshme për të shtuar në maksimum rezultatin e dobishëm.

Objektiva strategjike 2.10 *Forcimi i sistemit disiplinore për prokurorë dhe stafin prokurorial*

- Këshilli do të përgatitë një koncept dokument për t'ia dërguar Ministrisë së Drejtësisë duke mbështetur rekomandimin për ndryshimet e duhura në Ligjin për KPK-në dhe në ligjet tjera përkatëse që do të përfshijnë parimet dhe praktikat më të mira disiplinore në procedurat disiplinore të iniciuara nga Këshilli.
- Këshilli do të zbatojë dispozitat e Ligjit me ndryshime dhe plotësime, duke përfshirë ndryshimet në dispozitat për procedurat disiplinore të Ligjit, të cilat (Neni 23) përcaktojnë përbërjen e re të Komisionit Disiplinor, (në Nenin 25.3) përcakton afatin e parashkrimit për ankesat disiplinore, dhe (në Nenet 29.5 dhe 29.6) përcaktojnë mundësinë e ankimit në Këshill ndaj vendimeve të Komisionit Disiplinor dhe në rastet kur ka vonesa në pranimin e lëndës nga Komisioni Disiplinor të dërguar nga Zyra e Prokurorit Disiplinor që shkakton parashkrimin.



- Këshilli Prokurorial i Kosovës do të bëjë një vlerësim të nevojave që do të ndihmojë zhvillimin e strategjisë disiplinore me së paku pesë elemente.

Së pari, strategjia do të dallojë çështjet e performancës me sjelljen e pahijshme, dhe do të ofrojë një plan për trajnim riparues dhe masa tjera të duhura kur performanca duhet të përmirësohet. Një “çështje e performancës” ngritët kur një prokuror apo punonjës i stafit mbështetës dështon të përmbush pritjet e performancës në punë, ndërsa sjellja e keqe ndodh kur një prokuror apo punonjës i stafit mbështetës dështon të bindet me ndonjë rregull të pashkruar apo të shkruar të punës (preferohet të jetë i shkruar). Në disa raste neglijenca e një prokurori apo punonjësi të stafit mbështetës mund të kategorizohet si sjellje e pahijshme.

Problemet me performancë mund të ndodhin në situatat kur një prokuror apo punonjës i stafit mbështetës nuk është i kualifikuar për pozitën e tij/saj apo për shkak të mungesës së trajnimit, për shkak të rrethanave emergjente personale apo për shkak të kushteve të punës. Reagimi i punëdhënësit ndaj problemit me performancë në mënyrë tipike përfshin këshillimin për përmirësimin e performancës, trajnimin, ri caktimin e detyrave për të cilat prokurori apo punonjësi i stafit mbështetës është më i përshtatshëm dhe/apo masat e ngjashme. Paaftësia e një prokurori apo punonjësi të stafit mbështetës për të kryer punën në nivelin e mjaftueshëm pas këshillimit, trajnimit, ri caktimit apo masave të ngjashme mund të rezultojë në sanksione disiplinore përfshirë ndërprerjen e punësimit në rrethana ekstreme.


Në anën tjetër sjellja e keqe në përgjithësi përfshin dështimin për tu bindur ndaj një rregulli në vendin e punës nën rrethanat ku sjellja e një prokurori apo punonjësi të stafit mbështetës përfshin veprim me paramendim apo me qëllim në kuadër të kontrollit të një prokurori apo punonjësi të stafit mbështetës. Në mënyrë tipike, një prokuror apo punonjës i stafit mbështetës mund të përshkruhet se ka kryer sjellje të pahijshme kur ai/ajo ka vepruar me qëllim apo me paramendim duke qenë i vetëdijshëm për pasojat e veprimeve të tij/saj dhe/apo pasi që i është tërhequr vërejtja me gojë apo me shkrim kundër kryerjes së sjelljes së pahijshme, dhe kështu me radhë. Varësisht nga ashpërsia e sjelljes ofenduese, menaxherët shpesh do të përfshihen në proces disiplinor përparues ku sjellja e keqe e përsëritur trajtohet me sanksione të niveleve të rritura, me shkelje më serioze apo punëtorë më të pakorrigjueshëm marrin sanksione më të konsiderueshme.

Së dyti, strategjia do të parashihet proces të duhur ligjor kur Komisioni Disiplinor zgjidh një ankesë disiplinore. Me fjalë tjera, një vendim i kundërt i Komisionit Disiplinor duhet të mbështetet me fakte specifike dhe citatet e autoritetit ligjor dhe në veçanti të demonstrojë që Zyra e Prokurorit Disiplinor ka përmbushur obligimin e saj për të vërtetuar në shkallë të kërkuar me standardin e dëshmisë që i pandehuri ka shkelur ligjin, rregulloren apo rregullin e veçantë nën rrethanat ku i pandehuri ka ditur apo është dashur të dijë që sjellja ka qenë e gabuar.

Së treti, strategjia do të parashikojë qasje për trajnim dhe menaxhim të dizajnuar për të frenuar sjelljen e keqe dhe performancën e dobët.

Së katërti, strategjia do të ofrojë një plan për shmangien e vonesave në zgjidhjen e rasteve disiplinore.

Së pesti, strategjia do të parashikojë shqyrtimin dhe rishikimin e duhur të Rregullores së KPK-së për procedurën disiplinore në pajtim me konceptet e përmendura më lartë.




- Këshilli do të bëjë rishikimin e strategjisë së vet kundër konsideratave të përshkruara më lartë dhe kundër ndonjë standardi relevant dhe do të bëjë rregullime të tilla në strategji që janë të nevojshme për miratimin dhe zbatimin e praktikave më të mira disiplinore.
- Pas kësaj, Këshilli periodikisht do të vlerësoj efikasitetin e sistemit të tij të vlerësimit të performancës dhe të ndonjë standardi të performancës dhe do të bëjë rregullimet e nevojshme për të shtuar në maksimum rezultatin e dobishëm.

Objektiva strategjike 2.11 *Dispozita për trajnime specifike për prokurorë*

- Zhvillimi i karrierës dhe Planifikimi i vazhdueshëm: Plani duhet të jetë i dizajnuar që të mundësoj zhvillimin e karrierës i cili do të jetë në interes të individit dhe të institucionit duke përfshirë edhe Planifikimin e vazhdueshëm. Plani do të ofrojë gjithashtu edhe trajnime të tërthorta në mënyrë që të llogaritet në të papriturat e parashikuara në fusha të posaçme në mënyrë që të rritet kapaciteti i institucionit. Trajnimet me të gjera nuk duhet të dekurajohen. Këto trajnime duhet të inkurajohen. Detyrave të prokurorëve dhe të stafit mbështetës duhet tu epët prioritet i lartë kur janë në pyetje përprojekjet profesionale.
- Monitorimi dhe rishikimi: Efektiviteti i trajnimit objektiv dhe plani i përgjithshëm i trajnimit do të rishikohet në baza të rregullta duke përfshirë edhe sistemin e vlerësimit të performancës.
- Këshilli do të bashkëpunojë me Institutin Gjyqësor të Kosovës për të siguruar që secili prokuror të kryejë me sukses kurset bazike, ndërmjetme dhe të avancuara për arsyetimin ligjor dhe në të shkruar që janë të fokusuara në lloje të veçanta të lëndëve që merren prokurorët.
- Efikasiteti i arsyetimit ligjor dhe trajnimit në të shkruar dhe plani i përgjithshëm i trajnimit do të rishikohet në baza të rregullta duke përfshirë edhe sistemin e vlerësimit të performancës.

Objektiva strategjike 2.12 *Dispozita për trajnime të përbashkëta për prokurorë dhe stafin administrativ*

- Këshilli do të sigurojë se vlerësimi i nivelit të trajnimit që nevojitet për prokurorët dhe stafin mbështetës do të kryhet.
- Këshilli do të sigurojë se një trajnim për teknologjinë informative (i nivelit të caktuar) do të sigurohet për prokurorët dhe për stafin mbështetës.
- Monitorimi dhe rishikimi: Efektiviteti i trajnimit në teknologjinë informative dhe plani i përgjithshëm i trajnimit do të duhet të rishikohet në baza të rregullta, duke përfshirë edhe sistemin e vlerësimit të performancës..
- Vlerësim i nevojave për trajnime: Kjo do të kryhet me qëllim të vlerësimit të nevojave reale të trajnimit me qëllim të rritjes së aftësive profesionale dhe me qëllim që personat të cilët punojnë në shërbimet prokuroriale të kenë mundësi që detyrat e veta të kryejnë në mënyrë të paanshme dhe efektive në dritën e nevojave operative.
- Zhvillimi i planeve trajnuese të përgjithshme: Këshilli Prokurorial i Kosovës do të konsiderojë nevojat trajnuese për shërbimet prokuroriale duke marrë parasysh nevojat operative afatshkurtra dhe afatgjata. Ky plan duhet të parasheh fuqizimin e çdo lloji të aftësive nga specializimi në hetimin dhe ndjekjen e llojeve të caktuara të veprave penale



deri te aftësitë administrative në lidhje me efikasitetin e menaxhimit të rastit, deri te aftësitë legale dhe aftësitë legale në shkrim të cilat janë të nevojshme për një hetim efektiv dhe për ndjekje efektive të rasteve, deri te shkathhtësitë e nevojshme në gjykatore kur nevojitet performancë superiore në procedime ligjore, deri te aftësitë e lidërshiptit dhe aftësitë menaxheriale për prokurorë dhe për stafin mbështetës me rol menaxherial. Plani gjithashtu parashihet njohurinë e nevojshme kur është në pyetje konfidencialiteti, mbrojtja e te dhënave, etika dhe përputhja me ligjet, siç është Ligji mbi deklarimin e aseteve dhe Ligji mbi konfliktin e interesit. Gjithashtu, lidhur me emërimin, vlerësimin dhe disiplinën e prokuroreve dhe detajet e ligjeve të ndryshuara. Një rëndësi e posaçme do të kushtohet zhvillimit të trajnimit për prokurorë dhe stafin mbështetës dhe zhvillimin e kurikulimit struktural. Me qëllim të implementimit të planeve trajnuese do të ketë një bashkëpunim dhe koordinim me partnerët trajnues, duke i përfshirë edhe Institucionet Kosovare Gjyqësore dhe Ministrinë e Administratës Publike.

Në rolin e tij mbikëqyrës, Këshilli do të sigurohet se mundësitë për trajnime do të jenë në dispozicion për të gjithë prokurorët (në të gjitha nivelet e sistemit prokurorial), në mënyrë që të gjithë prokurorët (në të gjitha nivelet e sistemit prokurorial) janë të informuar me kohë lidhur me zhvillimet legale relevante (dhe çështjet tjera të aplikueshme). Këtu flitet për programe trajnuese të cilat janë të obligueshme ku do të ketë edhe monitorim të numrit të pjesëmarrësve. Ngjashëm, Këshilli do të sigurojë se do të ketë një kulturë për një trajnim të vazhdueshëm në sistemin prokurorial dhe burimet financiare, koha dhe gjërat tjera do të jenë në dispozicion për prokurorët të cilët do të marrin pjesë në këto aktivitete trajnuese. Këto do të jenë në dispozicion me mjetet e sistemit i cili është themeluar kështu që KPK do të jetë në gjendje të monitorojë sistemin dhe të jetë në dijeni se në këtë trajnim marrin pjesë ata persona të cilëve ju nevojitet ky trajnim specifik

- Monitorimi dhe rishikimi: Këshilli do të sigurohet që të ketë një rishikim të efektivitetit të trajnimit. Gjithashtu do të sigurohet që të ketë një rishikim në bazë të rregullt, duke përfshirë edhe mjetet e sistemit të vlerësimit të performancës.


Shtylla III: Rritja e aktiviteteve në terren dhe marrëdhëniet me publikun

Objektiva strategjike 3.1 *Promovimi i besimit të publikut në sistemin prokurorial përmes aktiviteteve publike në teren*

- Këshilli do të kryejë një vlerësim të nevojave në lidhje me komunikimet e jashtme, dhe pastaj do të përgatisë dhe zbatojë një strategji të përgjegjshme në mënyrë që të përmirësojë besimin e publikut në sistemin prokurorial dhe për të rritur ndërgjegjësimin publik të shkallës në të cilën sistemi prokurorial promovon qasjen e publikut në shërbimet e drejtësisë. Strategjia duhet të përfshijë të paktën tri elemente.

Së pari, ajo duhet të forcoj marrëdhëniet mes institucioneve të prokurorisë dhe mediave të lajmeve.


Së dyti, ajo duhet të sigurojë një fushatë të qasjes në publik që do të njoftojë publikun me natyrën dhe shtrirjen e përgjegjësisë dhe arritjet e institucionit, të ndërtojë respektin e publikut për institucionin, të inkurajojë publikun që të besojë në burimet e prokurorisë për zgjidhjen e duhur të konflikteve, dhe të përmirësojë marrëdhëniet në mes të publikut



dhe institucionit.

Së treti, ajo duhet të sigurojë një Ueb faqe që do të shërbejë si një mënyrë e komunikimit të drejtpërdrejtë midis institucionit dhe publikut.

- Këshilli do të vlerësojë periodikisht efektivitetin e strategjisë së tij të komunikimit të jashtëm, dhe të bëjë rregullime të tilla të strategjisë që mund të jenë të nevojshme për të maksimizuar një rezultat të dobishëm.
- Këshilli, përveç siç është kufizuar nga rregullat e prodhimit të të dhënave, do të aranzhojë për publikim procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit në Ueb faqen e KPK-së.
- Këshilli do të themelojë Komitetin për marrëdhëniet publike dhe/ose të caktuar një zëdhënës publik të trajnuar për zbatimin e objektivave të komunikimit publik të sistemit prokurorial në rolin e tij si mbikëqyrës i sistemit.
- KPK do të zhvillojë dhe do të mbajë fushata të qasjes me publikun për të informuar publikun për natyrën dhe shtrirjen e përgjegjësive dhe arritjeve të KPK-së dhe Prokurorit të Shtetit, respektin dhe besimin e ndërtuar, dhe për të përmirësuar ndryshe marrëdhëniet me publikun. KPK do të vlerësojë periodikisht efektivitetin dhe qasjen e programit, dhe të bëjë rishikimet e nevojshme për strategjinë e qasjes me publikun.
- Gjatë periudhës kohore të mbuluar nga ky Plan Strategjik, Këshilli do të vlerësojë dhe do të ndërmarrë hapa për të përmirësuar komunikimet e jashtme të Këshillit dhe të Prokurorit të Shtetit. Kjo do të përfshijë përgatitjen dhe zbatimin e një strategjie komunikimi të jashtëm. Hapat e ndërmarrë duhet të përfshijnë: (a) forcimin e marrëdhënieve ndërmjet shërbimit të prokurorisë dhe medias, (b) emërimin dhe trajnimin e zëdhënësit të mediave (c) zhvillimin e një faqe portali dhe faqen e internetit përdoruesit-miqësor për të siguruar komunikim të drejtpërdrejtë me publikun, (d) zhvillimin e fushatave të qasjes publike si e përshtatshme për ta informuar publikun për natyrën dhe shtrirjen e përgjegjësive dhe arritjet e Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit për ndërtimin e respektit të publik dhe besimin dhe për të përmirësuar ndryshe marrëdhëniet me publikun, dhe (e) zhvillimin e udhëzimeve të mediave dhe udhëzim të qartë për zëdhënësin e mediave dhe personave përkatës në lidhje me çfarë informacioni përgjithësisht duhet të jepet për mediat dhe çfarë duhet të mbetet konfidenciale.
- Këshilli do të marrë të gjithë hapat e nevojshëm për të siguruar përputhshmërinë me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave dhe qasjes në informacione zyrtare. Në ndërmarrjen e hapave për përmirësimin e komunikimit të tij të jashtëm, Këshilli duhet të sigurojë që kujdesi është marrë për të mbrojtur privatësinë dhe konfidencialitetin e personave të përfshirë në ndjekje penale, duke përfshirë viktimat, dëshmitarët dhe të tjerët.
- Këshilli do të vlerësojë periodikisht efektivitetin dhe qasjen komunikimit të tij të jashtëm dhe të bëjë rregullime të tilla që mund të jenë të nevojshme për të maksimizuar një rezultat të dobishëm.
- KPK do të përpilojë dhe mbajë një portal interneti dhe faqe interneti për përdoruesin e favorshëm dhe për të lehtësuar komunikimet e drejtpërdrejta me publikun në lidhje me kryerjen e shërbimit të prokurorisë nga këndvështrimi i Këshillit.



Objektiva strategjike 3.2 *Sigurimi i qasjes publike në raporte dhe dosje lidhur me të dhënat prokuroriale*

- Njësia e Këshillit të Vlerësimit të Performancës do të vlerësojë mjetet me të cilat mbledh informacion në lidhje me punën e kryer nga ana e shërbimit të prokurorisë, duke përfshirë zyrat prokuroriale.
- Duke u bazuar në rezultatet e vlerësimit, Njësia për Performancën e Vlerësimit do të përmirësojë analizën dhe prezantimin e informacionit të performancës së punës për të siguruar që pikat kyçe mund të kuptohen lehtë, dhe që performanca është përmirësuar si e përshtatshme.

Objektiva strategjike 3.3 *Sigurimi i konfidencialitetit të informatave, aty ku kërkohet me Ligje të Kosovës*

- Këshilli do të kryejë një vlerësim të obligimeve të mbrojtjes së të dhënave, dhe të ndërmarrë hapa për të siguruar që Prokurori i Shtetit është në përputhje me detyrimeve ligjore lidhur me mbrojtjen e të dhënave dhe konfidencialitetin - duke përfshirë që fuqia punëtore di në lidhje me përputhjen me obligimet ligjore.

Objektiva strategjike 3.4 *Mundësimi i qasjes në drejtësi të minoriteteve etnike dhe grupeve në rrezik*

- Këshilli do të miratojë një plan për përfshirjen e pakicës që do të zbatohet si pjesë e aspektit të marrëdhënieve publike të strategjisë së tij të komunikimit.


Shtylla IV: Përmirësimi I Objekteve dhe Teknologjisë

Objektiva strategjike 4.1 *Themelimi i një infrastrukture adekuate të teknologjisë informative*

- Këshilli do të sigurojë që vlerësimet për nevojat periodike për teknologjinë informative janë kryer dhe do të rishikoj ato, përfshirë këtu (në mesin e faktorëve tjerë) një llogaritje për: implikimet buxhetore, infrastrukturës hardverike, aplikacionet softverike, sigurisë së TI (teknologjisë informative), zhvillimit metodologjik të TI (p.sh., sistemet e menaxhimit të rastit, teknologjia e prezantimit të rasteve, resurset TI për zhvillimin e rastit), dhe aftësitë e ndërlidhura me TI për menaxhmentin e burimeve njerëzore.
- Këshilli do të sigurojë që të zhvillohet një strategji e teknologjisë informative për të zgjidhur këto nevoja.
- Këshilli do të vlerësojë dhe monitorojë strategjinë e teknologjisë së informacionit, do të bëjë rregullime të tilla aq sa të jetë e nevojshme për të maksimalizuar një rezultat të dobishëm dhe të monitorojë zbatimin e tij.

Objektiva strategjike 4.2 *Sigurimi i mjaftueshmërisë së objekteve prokuroriale*

- Këshilli periodikisht do të kryejë një vlerësim të nevojave në lidhje me ndërtesat e sistemit prokurorial dhe të infrastrukturës të objektit. Konsideratat do të përfshijnë sigurinë, dosjet dhe kapacitetin e ruajtjes së provave, kapacitetin për kërkesat e konfidencialitetit, disponueshmërinë e zyrës adekuate, nevojat për hapësirë në të ardhmen, planifikimet e




kushtëzuara (përfshirë marrëveshjet për pranimin e personelit të përkohshëm), e kështu me radhë.


- Pas konsiderimit të vlerësimit të nevojave për infrastrukturë fizike, Këshilli do të zgjedhë çfarëdo problemi që ka dalë nga vlerësimi.
- Këshilli do të konfirmojë se zyra e sapo hapur e prokurorisë i përmbushë të gjitha kërkesat e zbatueshme të përcaktuara nga Këshilli, dhe se transferimi në zyre të reja nuk i pengon funksionet prokuroriale.

Objektiva strategjike 4.3 *Sigurimi i sigurisë adekuate për prokurorë, personelin e prokurorive dhe objekteve prokuroriale*

- KPK-ja do të kryejë vlerësime periodike të administrimit të rrezikut, duke marrë parasysh sigurinë e personelit, planet primare dhe mbështetëse, reagime emergjente (p.sh., përgjigjet në zjarret, fatkeqësitë natyrore, ndërhyrjes së armatosur, terrorizmi), lokalet e sigurisë (duke përfshirë sigurinë fizike, sigurinë e dokumenteve konfidenciale dhe informacionit, dhe sigurinë e dëshmimeve), planet për sigurimin fizik dhe planet mbështetëse, çështja e strukturës së ndërtesave (duke përfshirë edhe problemet strukturore), planet e paparashikuara, dhe të sigurisë ciklike dhe auditimit të sigurisë (përfshirë me pajisjen e nevojshme dhe intervenimet trajnuese të cilat nevojiten për përgjigjet emergjente).
- Këshilli do të miratojë një plan të sigurisë emergjente, duke përfshirë dispozitat për përgjigje emergjente, si një demonstrim i qëllimit për të zgjidhur çështjet e sigurisë në mënyrë që të mbrojtë jetën e punonjësve, si dhe pajisjeve, dokumenteve dhe pronave që duhet ruajtur.
- Këshilli do të sigurojë që punonjësit e duhur janë të trajnuar për të zbatuar dhe për të kryer vlerësime periodike të implementimit të planit të sigurisë, dhe ai do të marrë çdo masë të nevojshme për të zgjidhur sfidat që dalin nga vlerësimi, duke përfshirë miratimin e ndonjë akti të nevojshëm nënligjor.
- KPK do të kryejë vlerësime periodike të obligimeve për mbrojtjen e të dhënave, si dhe nivelin e përputhshmërisë së shërbimit të prokurorisë me obligimet ligjore lidhur me mbrojtjen e të dhënave.
- KPK do të monitorojë, vlerësojë dhe të rishikojë sipas nevojës të gjitha strategjitë e sigurisë.



Shtojca 2 - Plani i Veprimit të KPK



Plani i Veprimit të KPK

Objektivat Strategjike	Aktivitetet	Përgjegjësi	Tregues	Afati i fundit
Objektiva Strategjike 1.1 <i>Ngritja e përgjegjësisë institucionale dhe përditësimi i procesit buxhetor.</i>	Aktiviteti 1.1.1: Në pajtim me Nenin 13 të Ligjit me ndryshime dhe plotësime, Këshilli do të krijojë të gjithë mekanizmat e përshtatshëm për menaxhimin e përgjegjësisë të tij për përgatitjen dhe dorëzimin e draft buxhetit vjetor për shqyrtim dhe miratim nga Kuvendi dhe më pas për administrimin e buxhetit, duke përfshirë mbikëqyrjen e shpenzimeve, alokimin e fondeve, mirëmbajtjen e saktë dhe azhurnimin e llogarive dhe auditimet financiare.	<ul style="list-style-type: none"> ▪ KPK ▪ Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel i KPK ▪ SKPK 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Rregulloret ▪ Vendimet ▪ Udhëzimet Administrative ▪ Kërkesa buxhetore ▪ Buxheti i KPK-së 	Dhjetor 2017
	Aktiviteti 1.1.2: Këshilli do të kërkojë delegimin e autoritetit për të administruar buxhetin e Zyrës së Prokurorit Disiplinor te Sekretariati i ZPD, dhe për të shqyrtuar e miratuar delegimet e brendshme financiare të KPK-së si një Organizatë Buxhetore.	<ul style="list-style-type: none"> ▪ KPK ▪ ZPD 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dokument me rekomandime në MD ▪ Vendime 	Dhjetor 2017
	Aktiviteti 1.1.3: Këshilli do të përmirësojë qarkullimin e rregulloreve të brendshme buxhetore dhe oraret në Prokurori, Departamentet dhe Njësitë mbi të cilat menaxheri i i financave mbështetet për informacion të detajuar të buxhetit, e që është konsoliduar më pas në buxhetin e KPK-së nga ana e Sekretariatit. Për më tepër, Këshilli do të zhvillojë procedura standarde operative për aspektet relevante të procesit të përcaktimit të buxhetit, të tilla si përcaktimi i qëllimeve, objektivave, dhe treguesve të performancës. Së fundi, Këshilli do të sigurojë që vlerësimi i nevojave për trajnim realizohet në këtë aspekt, dhe se trajnimi i duhur është kryer.	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel ▪ SKPK 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Procedura Standarde të Veprimit 	Dhjetor 2017
	Aktiviteti 1.1.4: Këshilli do të vendosë një mekanizëm që do të sigurojë monitorim të vazhdueshëm buxhetor dhe për të rritur kapacitetin për raportimin financiar tremujor dhe vjetor. Ai gjithashtu do të përmirësojë përmbajtjen e prezantimit të buxhetit, si dhe procesin e paraqitjes së raporteve financiare në Komisionin e KPK-së për Buxhet dhe Financa. Për më tepër, Këshilli do të punojë për të rritur vetëdijen dhe rëndësinë e përmbajtjes së	<ul style="list-style-type: none"> ▪ KPK ▪ Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel ▪ SKPK 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Procedura Standarde të Veprimit 	Dhjetor 2017

<p>raportit të revizionit (auditimit), çështjet materiale që dalin për shqyrtim në nivel të Bordit dhe veprim të duhur, si dhe të zhvillojë veprimet e nevojshme përcjellëse bazuar në gjetjet e auditimit, siç janë raportet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe të auditorëve të brendshëm.</p>			
<p>Aktiviteti 1.1.5: Këshilli do të rrisë ndërgjegjësimin dhe të kuptuarit e anëtarëve të tij, si dhe anëtarëve të Komisionit të Buxhetit dhe Financave të KPK, në lidhje me përgjegjësinë e tyre për të siguruar se nuk ka përgjegjshmëri për ngritjen, miratimin, monitorimin dhe mbikëqyrjen e buxhetit të KPK-së. Komisioni për Buxhet dhe Financa i KPK-së do të përmirësojë planifikimin paraprak të pikave të agjendës së Këshillit me fokus të veçantë në orarin e procesit të përcaktimit të buxhetit vjetor, rishikimin buxhetor në mes të vitit, prezantimin e shifrave të realizuara, si dhe shqyrtimin dhe përgjigjet në gjetjet e raportit të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ KPK ▪ Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel ▪ SKPK 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Agjendat e takimeve/tryezave të KPK-së ▪ Raportet e takimeve/tryezave të KPK-së 	<p>Shtator 2017</p>
<p>Aktiviteti 1.1.6: Këshilli do të ndërmarrë hapa për ndërtimin e kapaciteteve të menaxherëve jo-financiarë që ofrojnë të dhëna financiare për planifikimin, zbatimin, dhe procesin e monitorimit të buxhetit në mënyrë që të përmirësojë efektivitetin dhe efikasitetin e atij procesi. Në mënyrë të ngjashme, Këshilli do të ndërmarrë hapa për të ndërtuar kapacitetet e zyrtarëve financiarë në prokurori në mënyrë që të bëjnë planifikimin, ekzekutimin, dhe procesin e monitorimit të buxhetit të KPK-së.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel ▪ SKPK 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Program trajnimi ▪ Udhëzues ▪ Agjenda dhe raportet e trajnimeve 	<p>Dhjetor 2018</p>
<p>Aktiviteti 1.1.7: Këshilli do të miratojë apo përmirësojë rregulloret dhe afatet kohore të brendshme lidhur me buxhetin që ndihmojnë Prokuroritë, Departamentet dhe Njësitet ku mbështetet Menaxheri Financiar për informata rreth buxhetit dhe e cila pastaj konsolidohet në buxhet të KPK-së me zyrtarët e vet administrativ.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ KPK ▪ SKPK ▪ Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Rregulloret ▪ Vendimet ▪ Planet e veprimit 	<p>Dhjetor 2018</p>
<p>Aktiviteti 1.1.8: Këshilli do të zhvillojë dhe miratojë procedurat standarde të veprimit lidhur me dokumentet specifike që nevojitet si pjesë e procesit të caktimit të buxhetit që do të përfshijë, për shembull, qëllimet, synimet specifike</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ SKPK ▪ Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Procedura Standarde të Operimit 	<p>Dhjetor 2017</p>

	dhe treguesit e performancës.			
	Aktiviteti 1.1.9: Këshilli do të ndërmarrë hapa për të përmirësuar përmbajtjen e paraqitjes së buxhetit si dhe procesin për paraqitjen e raporteve financiare tek Komisioni i KPK-së për Buxhet & Financa.	<ul style="list-style-type: none"> SKPK Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel 	<ul style="list-style-type: none"> Udhëzues për planifikim, prezantim dhe raportim 	Dhjetor 2017
	Aktiviteti 1.1.10: Këshilli do të kryejë vlerësime periodike të efikasitetit të kontrolleve buxhetore dhe të prokurimit, përfshirë ato lidhur me të gjeturat dhe rekomandimet e pasqyruara në raportet e përgatitura nga Auditori i Përgjithshëm.	<ul style="list-style-type: none"> Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel Drejtori i SKPK 	<ul style="list-style-type: none"> Plani i punës së KPK-së Plan i Auditimit i NJAB-it Raporte 	Dhjetor 2018
	Aktiviteti 1.1.11: Këshilli do të zhvillojë, monitorojë dhe bëjë rishikimet e nevojshme në strategji për kontrollet buxhetore dhe të prokurimit që do të jenë në përputhje me të gjeturat dhe rekomandimet e pasqyruara në raportet e përgatitura nga Auditori i Përgjithshëm.	<ul style="list-style-type: none"> Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel SKPK (Njësia e Auditimit, Prokurimi dhe njësitë tjera të SKPK) 	<ul style="list-style-type: none"> Plani për Zbatimin e Rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm Vlerësim i zbatimit të rekomandimeve lidhur me buxhetin dhe prokurimin. 	Dhjetor 2018
	Aktiviteti 1.1.12: Këshilli do të ndërmarrë hapa për të shtuar vetëdijen dhe rëndësinë e përmbajtjes së raportit të auditimit si dhe do të krijojë një proces për të adresuar çështjet materiale që kërkojnë shqyrtim në nivel të Bordit, veprim dhe përcjellje që rezultojnë nga të gjeturat e auditimit nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm dhe auditorët e brendshëm.	<ul style="list-style-type: none"> KPK Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel SKPK (Njësia e Auditimit) 	<ul style="list-style-type: none"> Procesverbali i takimeve të rregullta të KPK-së; Vendimet e KPK-së. 	Dhjetor 2017
Objektiva strategjike 1.2 Krijimi i një procesi të emërimit, përbërjes dhe	Aktiviteti 1.2.1: Këshilli do të ndërmarrë të gjithë hapat sipas dispozitave të Ligjit për ndryshim dhe plotësim që ndërlidhen me procesin e emërimit, përbërjen dhe statusin e KPK-së, duke përfshirë, ndër tjera, Nenin 5, 5A, 10, 14 dhe 14A.	<ul style="list-style-type: none"> KPK Komisioni për Çështje Normative SKPK 	<ul style="list-style-type: none"> Rregullorja për organizimin dhe veprimtarinë e KPK-së Rregullorja për zgjedhjen e anëtareve të KPK-së; 	Mars 2016

<p>statusit të KPK-së që është në pajtim me standarde Evropiane</p>			<ul style="list-style-type: none"> ▪ Rregullorja për zgjedhjen e Kryesuesit dhe Zëvendës kryesuesit; ▪ Shpallja për zgjedhjen e anëtarëve të KPK-së 	
	<p>Aktiviteti 1.2.2: Të përgatisë dokument paraprak për dorëzim në Ministrinë e Drejtësisë që mbështet rekomandimin për ndryshimin e Ligjit për KPK-së për të krijuar pozitën e Zëvendës kryesuesit të Këshillit, me një përshkrim të përgjegjësive të veçanta të Zëvendës kryesuesit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ SKPK, ▪ Komisioni i Akteve Normative e KPK-së 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dokumenti me rekomandime për MD 	<p>Dhjetor 2017</p>
	<p>Aktiviteti 1.2.3: Këshilli do të mirëmbajë dhe do të vazhdojë të publikojë në internet strukturën e tanishme të veçantë që reflekton pavarësinë e KPK-së nga ZPSH-ja.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Sekretariati i KPK-së 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Rregullorja për organizimin dhe veprimtarinë e KPK-së ▪ Rregullorja për organizimin e brendshëm të PSH-së ▪ Organogrami i KPK-së 	<p>Mars 2016</p>
	<p>Aktiviteti 1.2.4: Këshilli do të monitorojë dhe do të vazhdojë të përmirësojë strukturën e tij të brendshme duke zhvilluar më tutje Komisionin për Buxhet, Financa dhe Personel, sipas nevojës.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ KPK ▪ Komisioni për Çështje Normative ▪ Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel ▪ SKPK 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Rregullore për organizimin dhe veprimtarinë të KPK-së ▪ Rregullore për komisionin për buxhet dhe financa ▪ Rregullorja për SKPK 	<p>Mars 2017</p>

<p><u>Aktiviteti 1.2.5:</u> Këshilli do të monitorojë dhe do të vazhdojë të përmirësojë strukturën e tij të brendshme duke zhvilluar më tutje Komisionin për Akte Normative, sipas nevojës.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ KPK ▪ SKPK 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Rregullore për organizimin dhe veprimtarinë e KPK-së ▪ Rregullore për komisionin për akte normative 	<p>Mars 2016</p>
<p><u>Aktiviteti 1.2.6:</u> Këshilli do të monitorojë dhe do të vazhdojë të përmirësojë strukturën e tij të brendshme duke zhvilluar më tutje për Administrimin e Prokurorive, sipas nevojës.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ KPK ▪ SKPK 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Rregullore për organizimin dhe veprimtarinë të KPK-së ▪ Rregullore për komisionin për administrimin e zyrave të prokurorisë ▪ Vendimi i KPK-së për Themelimin e Komisionit për Administrimin e Prokurorive 	<p>Qershor 2017</p>
<p><u>Aktiviteti 1.2.7:</u> Këshilli do të monitorojë dhe do të vazhdojë të përmirësojë strukturën e tij të brendshme duke zhvilluar më tutje Komisionin Disiplinor, sipas nevojës.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ KPK ▪ SKPK ▪ NJSHPP 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Rregullore për organizimin dhe veprimtarinë e KPK-së ▪ Vendimi i KPK-së për themelimin e Komisionit Disiplinor 	<p>Mars 2016</p>
<p><u>Aktiviteti 1.2.8:</u> Këshilli do të monitorojë dhe do të vazhdojë të përmirësojë strukturën e tij të brendshme duke zhvilluar më tutje Komisionin për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve, sipas nevojës.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ KPK ▪ SKPK ▪ NJSHPP 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Rregullore për organizimin dhe veprimtarinë e KPK- 	<p>Mars 2016</p>

			<ul style="list-style-type: none"> ▪ së ▪ Vendimi i KPK-së për themelimin e Komisionit për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve 	
Aktiviteti 1.2.9: Këshilli do të monitorojë dhe do të vazhdojë të përmirësojë strukturën e tij të brendshme duke krijuar komisione të tjera të përhershme dhe <i>ad hoc</i> sipas nevojës për të përmirësuar punën e tij.	<ul style="list-style-type: none"> ▪ KPK 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Vendimet e KPK-së për themelimin e Komisioneve ad hoc 		Dhjetor 2018
Aktiviteti 1.2.10: Këshilli do të monitorojë dhe do të vazhdojë të përmirësojë strukturën e tij të brendshme duke u siguruar që ekzistenca dhe kompetencat e komisioneve të Këshillit do të kenë një bazë në ligj, me fleksibilitet për të krijuar komisione të përhershme dhe <i>ad hoc</i> sipas nevojës.	<ul style="list-style-type: none"> ▪ KPK ▪ Komisioni për Çështje Normative ▪ SKPK 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Vendimet e KPK-së ▪ Raporte dhe analiza ligjore 		Dhjetor 2018
Aktiviteti 1.2.11: Me përjashtim të Komisionit Disiplinor, Këshilli do të sigurojë që asnjë komision mos të ketë fuqi vendimtare, dhe se do të kërkohet nga të gjitha komisionet ti japin Këshillit raport shpjegues dhe dokumentacione tjera duke mbështetur vendimin e rekomanduar nga Komisioni.	<ul style="list-style-type: none"> ▪ KPK ▪ Komisioni për Çështje Disiplinore 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Vendimet e KPK-se ▪ Raportet e Komisioneve 		Dhjetor 2018
Aktiviteti 1.2.12: Për të mbrojtur integritetin, efikasitetin, dhe efektivitetin e komisioneve të Këshillit, Këshilli do të përgatisë një dokument paraprak për dorëzim në Ministrinë e Drejtësisë i cili mbështet rekomandimin e një amendamenti në Ligjin për KPK-në ose ndërmarrjen e hapave të tjerë që do të reflektojnë rregullat bazë për përbërjen e komisioneve, dhe që do të sigurojë : Mundësimin e pjesëmarrjes së një numri mjaftueshëmrisht të lartë të anëtarëve të komisionit për të lejuar një diskutim të gjerë, por një numër mjaft të ulët të anëtarëve për të lejuar punë të qetë. Përcaktimin se nëse përfaqësuesit e profesioneve të tjera janë anëtarë të një	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Komisioni i Akteve Normative e KPK-së ▪ SKPK 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dokumenti me rekomandime për MD 		Dhjetor 2017



<p>komisioni, numri i prokurorëve në komision duhet të jetë një shumicë.</p> <p>Përcaktimin e disa rregullave themelore të procedurës së komisionit, të tilla si kuorum, hedhje e votës, zgjidhje për situatat në të cilat ka vota të barabarta, dhe kështu me radhë.</p> <p>Ndalimi i Kryesuesit të KPK-së që të shërbejë në ndonjë komision për shkak të natyrës së detyrave të Kryesuesit.</p>			
<p>Aktiviteti 1.2.13: Këshilli do të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për të siguruar që anëtarët e komisionit janë të liruar nga detyra të tjera në atë masë që është e nevojshme në mënyrë që përgjegjësia për të përgatitur projekt-vendime dhe të angazhohen në diskutime në lidhje me punën e komisionit. Në veçanti, do të përdoret një parim rotacioni për përbërjen e Komisionit Disiplinor, dhe do të përdoret një sistem i alternuar i raportimit në mënyrë që të ndahet ngarkesa e punës.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ KPK 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Rregulloret ▪ Vendimet e KPK-së 	<p>Dhjetor 2018</p>
<p>Aktiviteti 1.2.14: Të bëhet një vlerësim i nevojave për të përcaktuar numrin minimal të personelit ndihmës të nevojshëm për të mbështetur Këshillin, dhe në lidhje me përmirësimet tjera të nevojshme për mbështetjen e pjesëtarëve të KPK-së.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ KPK ▪ SKPK 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Vlerësimi i Nevojave ▪ Rregullorja për strukturën organizative të SKPK-së 	<p>Dhjetor 2016</p>
<p>Aktiviteti 1.2.15: Të bëhet një vlerësim i nevojave për ofrim të trajnimit të duhur për të ndihmuar pjesëtarët e KPK-së në kryerjen e detyrës së mbikëqyrjes dhe përgjegjësi të tjera. Këshilli do të përgatisë planet e trajnimit si të dobishme dhe do të zbatojë trajnim të duhur për pjesëtarët e KPK-së. Këshilli do të themelojë një Komision <i>ad hoc</i> të Trajnimit, i cili do të koordinohet me Institutin Gjyqësor të Kosovës për të kryer përgjegjësitë specifike të këtij funksioni.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Komisioni ad hoc i themeluar nga KPK ▪ NJSHPP 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Vendimi për themelimin e Komisionit ▪ Dokumenti për vlerësim të nevojave për trajnim ▪ Programi trajnues 	<p>Mars 2017</p>
<p>Aktiviteti 1.2.16: Rritja e aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve në mënyrë që të përgatisin anëtarët e stafit mbështetës për ofrimin e ndihmës së përgjegjshme, profesionale, dhe efikase në funksionimin e Këshillit. Veçanërisht vëmendje do t'i kushtohet ngritjes së kapaciteteve të sekretarëve juridik të caktuar për</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ NJSHPP dhe SKPK në bashkëpunim me IGJK dhe partnerët e KPK-së 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Vlerësimi i nevojave ▪ Programi trajnues ▪ Raportet e trajnimeve 	<p>Dhjetor 2018</p>

<p>Komisionet, si dhe kryetarët e njësive dhe zyrave në Sekretariat dhe Njësinë e Vlerësimit dhe të Performancës, duke përfshirë në lidhje me (a) krijimin e dokumentacionit të duhur të gjitha vendimeve, duke përfshirë indeksimin, (b) mirëmbajtjen e dosjeve dhe komunikimit me palët në punën e KPK-së, (c) duke siguruar zbatimin e unifikuar të ligjit, dhe (d) përmirësimin e kapacitetit kërkimor ligjor të Këshillit. Në këtë drejtim, Këshilli gjithashtu do të sigurojë trajnim të vazhdueshëm të përbashkët për të mbështetur anëtarët e stafit në lidhje me rekrutimin, vlerësimin, dhe aktivitetet disiplinore të KPK-së dhe komisioneve të tij, si dhe çështjeve të tjera që do të sigurojnë një kuptim të plotë të rolit të stafit mbështetës në këto procese, të cilat do të kryhen në mënyrë që të krijojnë një ambient bashkëpunues të koordinuar që do të lehtësojë arritjen e objektivave institucionale.</p>			
<p>Aktiviteti 1.2.17: Këshilli do të miratojë dhe do të ndjekë planet vjetore të punës, planet e veprimit, si dhe dokumentet e tjera të planifikimit për të arritur rezultatet në këtë Plan Strategjik. Në veçanti, Këshilli do të sigurojë që planet e punës vjetore, planet e veprimit, dhe planet e tjera të punës janë në sinkronizim me Planin Strategjik në mënyrë që të gjitha përpjekjet janë të drejtuara në drejtim të realizimit të qëllimeve dhe objektivave që janë vlerësuar si prioritet nga procesi i diskutimit që rezultoi në miratim të Planit Strategjik.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ KPK ▪ Komisionet e KPK-së ▪ SKPK dhe ▪ NJSHP 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Planet vjetore të punës ▪ Planet e veprimit 	<p>Dhjetor 2018</p>
<p>Aktiviteti 1.2.18: Këshilli do të vendosë një proces të monitorimit dhe vlerësimit për të siguruar përmbushjen e qëllimeve të përcaktuara nga planet e punës, planet strategjike, si dhe dokumentet tjera të planifikimit, të cilat do të përfshijnë punësimin e një specialisti i cili do të koordinojë materialet e monitorimit dhe vlerësimit. Koordinatorin e monitorimit dhe vlerësimit ndër të tjera, do të marrë parasysh raportet, në bazë të një orari të caktuar, nga Njësia e Vlerësimit të Performancës së KPK-së, Komisioneve të KPK-së, si dhe mekanizmave të tjerë dhe burimeve të informatave në mënyrë që të ndihmojë Këshillin në kryerjen e shqyrtimeve të tij që janë kryer në bazë të provave. Si shembuj, çështjet e këtyre aktiviteteve do të përfshijnë:</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ KPK ▪ Komisionet e KPK-së ▪ SKPK dhe ▪ NJSHP 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Vendimet e KPK-së ▪ Rregullorja për SKPK ▪ Planet vjetore të punës ▪ Planet e veprimit 	<p>Dhjetor 2018</p>



	<p>Përditësimin nga Komisionit për Buxhet.</p> <p>Funksionimin e Regjistrave të Prokurorisë.</p> <p>Progresin në arritjen e Objektivave të Planit Strategjik në Bashkëpunim Ndërinstitucional në Luftën kundër Krimit të Organizuar.</p> <p>Progresin drejt përmbushjes së angazhimeve të tij sipas Strategjisë Kombëtare të Anti-Korrupsionit dhe Planit të Veprimit.</p> <p>Progresin në arritjen e objektivave të këtij Planit Strategjik.</p> <p>Raportet të tjera sipas nevojës.</p>			
<p>Objektiva strategjike 1.3</p> <p>Qartësimi i rolit dhe strukturës organizative të Sekretariatit</p>	<p>Aktiviteti 1.2.19: KPK-ja do të marrë parasysh potencialin për përmirësimin e efikasitetit të Këshillit përmes mbështetjes në seancat më pak të shpeshta dhe/ose më të gjata.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ KPK ▪ Komisionet e KPK-së ▪ SKPK ▪ NJSHP 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Rregullorja për organizimin dhe veprimtarinë e KPK-së ▪ Vendimet e KPK-së ▪ Planet e punës së KPK-së 	<p>Dhjetor 2018</p>
	<p>Aktiviteti 1.3.1: Këshilli do të zbatojë Nenet 14 dhe 14A të Ligjit me ndryshime dhe plotësime lidhur me themelimin e Sekretariatit të Këshillit dhe emërimin e Drejtorit të Sekretariatit të KPK.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ KPK ▪ SKPK 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Vendimi për emërimin e Drejtorit të SKPK-së ▪ Rregullorja për organizimin e SKPK-së 	<p>Dhjetor 2016</p>
	<p>Aktiviteti 1.3.2: Këshilli do të theksojë pavarësinë e tij institucionale gjatë ushtrimit të përgjegjësisë së tij për mbikëqyrjen e Zyrës së Prokurorit të Shtetit, dhe në lidhje me këtë do të bëjë ndonjë ndryshim nëse është e nevojshme për të siguruar pavarësinë e Këshillit, dhe për të treguar atë pavarësi përmes</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ KPK ▪ ZKPSH 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Rregullorja për veprimtarinë dhe organizimin e KPK-së 	<p>Dhjetor 2016</p>

	publikimit të një strukture organizative të veçantë të kornizës së Këshillit.		<ul style="list-style-type: none"> ▪ Rregullorja për Organizimin dhe Veprimtarinë e PSH-së ▪ Rregullorja për SKPK-në 	
	Aktiviteti 1.3.3: Këshilli do të kryej një studim për decentralizimin e menaxhimit për të përcaktuar se cila, nëse ka, detyra të Sekretariatit duhet të transferohen, ose të ndahen me Zyrat individuale të Prokurorisë në mënyrë që të përmirësohet efikasiteti në administrimin e sistemit prokurorial.	<ul style="list-style-type: none"> ▪ KPK 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Analizë lidhur me decentralizimin e shërbimeve në sistemin prokurorial 	Dhjetor 2017
	Aktiviteti 1.3.4: Bazuar në rezultatet e studimit të decentralizimit, Këshilli do të miratojë ndryshime të tilla në procedurat e menaxhimit siç janë të justifikuar nga studimi.	<ul style="list-style-type: none"> ▪ KPK 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Vendim i KPK-së lidhur me rezultatet e analizës për decentralizimin e shërbimeve në sistemin prokurorial 	Dhjetor 2017
	Aktiviteti 1.3.5: Këshilli do të sigurohet që prokurorët dhe personeli ndihmës i prekur nga çdo vendim i decentralizimit të trajnohen në lidhje me strukturën e re, veçanërisht duke përfshirë funksionet e buxhetit dhe financave, të cilat do të dizajnohen për të ruajtur efikasitetin maksimal.	<ul style="list-style-type: none"> ▪ KPK ▪ PSH ▪ SKPK ▪ NJSHP 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Vlerësimi i nevojave ▪ Programi trajnues 	Dhjetor 2018
Objektiva strategjike 1.4 Rritja e planifikimit të politikave	Aktiviteti 1.4.1: Këshilli do të themelojë një zyrë të Planifikimit Strategjik, ose, të paktën, të caktojë zyrtarë për të kryer hulumtime të politikave, të kryejë mbështetje të planifikimit për Këshillin, dhe për të ndihmuar në përmirësimin e administratës për praktikën më të mira prokuroriale.	<ul style="list-style-type: none"> ▪ KPK ▪ SKPK 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Vendim ▪ Rregullorja e SKPK-së 	Janar 2017
Objektiva strategjike 1.5 Miratim i	Aktiviteti 1.5.1: Këshilli do të përgatisë një koncept dokument për dorëzim në Ministrinë e Drejtësisë duke mbështetur rekomandimin për amendamentimin e ligjeve përkatëse dhe, sipas nevojës edhe Kushtetutës, në mënyrë që ajo të arrijë stabilitetin e infrastrukturës së saj, duke përfshirë konsideratat e cekura më	<ul style="list-style-type: none"> ▪ KPK ▪ Komisioni për Çështje Normative ▪ SKPK 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dokument me rekomandime 	Dhjetor 2017

proceseve që KPK do përdorë për hartimin dhe miratimin e rregulloreve dhe akteve tjera nënligjore

<p>poshtë:</p> <p>Domosdoshmërinë e një amendamenti kushtetues, amendamenti ligjor, ose interpretimi ligjor që do të sqaronte pushtetin e Këshillit për të nxjerrë rregulla, dhe te jep autoritet në Gjykatën Kushtetuese për shqyrtimin e rregulloreve të tilla sepse duket se Kushtetuta aktualisht parashikon vetëm shqyrtimet e rregulloret e nxjerra nga dega e ekzekutivit.</p> <p>Këshilli do të përgatisë një dokument paraprak për dorëzim në Ministrinë e Drejtësisë duke mbështetur rekomandimin që Ligji për KPK-në të ndryshohet për të përshkruar në mënyrë specifike llojet e akteve normative që Këshilli është i autorizuar të nxjerrë, duke përfshirë rregulloret (ndryshimet në rregullore), vendime (të drejtuara nga një apo më shumë individ), dhe udhëzimet (duke përfshirë udhëzimet e përgjithshme ose qarkore të drejtuara në një ose më shumë individë).</p> <p>Këshilli do të përgatisë një koncept dokument për dorëzim në Ministrinë e Drejtësisë duke mbështetur rekomandimin që Ligji për KPK-në, në mënyrë eksplicite të identifikoj se ku vendimet publike, apo dokumente të tjera publike, të KPK-së duhet të publikohen.</p>			
<p>Aktiviteti 1.5.2: Brenda fushëveprimit të kompetencave të veta, Këshilli do të miratojë një rregull në lidhje me publikimin e vendimeve të KPK-së në qoftë se Ligji për KPK-në nuk ndryshohet në mënyrë që të kërkojë publikim.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ KPK 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Rregullorja për organizimin dhe veprimtarinë e KPK-së 	<p>Mars 2016</p>
<p>Aktiviteti 1.5.3: Brenda fushëveprimit të kompetencave të veta, Këshilli do të miratojë një rregull që do të referohet në rregulloret dhe vendimet në datën e publikimit, si datën në të cilën akti përkatës hyn në fuqi, dhe në dokumentet e tilla gjithashtu do të specifikohet data e publikimit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ KPK ▪ Komisioni për Çështje Normative ▪ SKPK 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Udhëzim Administrativ për përcaktimin e kohës se hyrjes në fuqi të akteve normative të KPK-së 	<p>Dhjetor 2017</p>

<p>Objektiva strategjike 1.6</p> <p>Përmirësimi i koordinimit në mes të KPK-së, Sekretariatit të KPK-së dhe Prokurorive</p>	<p>Aktiviteti 1.6.1: Këshilli do të sigurojë që mekanizmi ekzistues për komunikim të brendshëm të vlerësohet, se nevojat për komunikim të vlerësohen, dhe që të merren hapa për të përmirësuar komunikimin ekzistues të brendshëm. Kjo do të përfshijë përgatitjen dhe zbatimin e planit të komunikimit të brendshëm apo strategjisë. Këto hapa duhet të sigurojnë që të gjithë personat që punojnë në kuadër të shërbimit të prokurorisë kanë qasje në gjuhët e tyre për informacionet që iu nevojitet për të kryer detyrat e tyre në mënyrë profesionale, efektive dhe efikase, dhe janë të vetëdijshëm për zhvillimet kryesore që ndikojnë në punën e tyre.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ KPK ▪ Zyra për komunikim me publikun e KPK ▪ Zyra për komunikim me publikun e ZKPSH 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Rregullorja për komunikim me publikun ▪ Plani për komunikim me publikun e KPK ▪ Plani për komunikim me publikun e ZKPSH 	<p>Mars 2017</p>
<p>Objektiva strategjike 1.7</p> <p>Përmirësimi i koordinimit të veprimeve me organe ndërkombëtare dhe organe tjera kombëtare, si Ministrinë e Drejtësisë, Institutin Gjyqësor të Kosovës, Policinë e Kosovës dhe Odën e Avokatëve</p>	<p>Aktiviteti 1.7.1: Pa kompromentuar pavarësinë e gjyqësorit nga funksionet e sistemit të prokurorisë, Këshilli do të përgatisë një koncept dokument për dorëzim në Ministrinë e Drejtësisë i cili mbështet një rekomandim që Ligjet për KPK-në dhe KGJK-në të ndryshohen për të vendosur një mekanizëm ndër-Këshillues të koordinimit dhe bashkëpunimit në mënyrë që të përmirësojë ndërveprimin ndërmjet KGJK-së dhe KPK-së, të cilat mund të përfshijnë vëzhgimet e aktiviteteve të Këshillit nga një anëtar i Këshillit përkatës, takime të detyrueshme të rregullta mes Drejtorëve përkatës të Sekretariatit dhe shefave të departamenteve.</p> <p>Aktiviteti 1.7.2: Për aq sa është e nevojshme, Këshilli do të përmirësojë ndërlidhjen e tij me Ministrinë e Drejtësisë për shkak se ajo është e nevojshme për të siguruar që ligjet që ndikojnë në sistemin prokurorial janë propozuar ose rishikuar në mënyrë që çështjet relevante janë zgjidhur.</p> <p>Aktiviteti 1.7.3: Këshilli do të vazhdojë të bashkëpunojë ngushtë me Institutin Gjyqësor të Kosovës në mënyrë që të përmbushë detyrimin e tij mbikëqyrës për të siguruar që përpjekjet e trajnimit arrijnë pritjet profesionale të këtij Plani Strategjik.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ KPK ▪ SKPK ▪ Komisioni për Çështje Normative ▪ SKPK ▪ KPK ▪ NJSHPP ▪ SKPK 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dokument me rekomandime në MD ▪ Vendime ▪ Dokument me rekomandime ▪ Dokument me rekomandime 	<p>Dhjetor 2017</p> <p>Dhjetor 2017</p> <p>Dhjetor 2017</p>






	<p>Aktiviteti 1.7.4: Për sa kohë që pjesëtarët e stafit mbështetës të sistemit prokurorial janë punonjës të Ministrisë së Administratës Publike, Këshilli do të bashkëpunojë ngushtë me zyrën e trajnimit të MAP-it në mënyrë që të përmbushë detyrimin e tij të mbikëqyrjes për të siguruar që përpjekjet e trajnimit përmbushin pritjet profesionale të këtij Plani Strategjik. Përveç kësaj, në qoftë se pjesëtarët e stafit mbështetës të sistemit prokurorial bëhen punonjës të sistemit të prokurorisë, Këshilli do të bashkëpunojë me zyrat e duhura në mënyrë që të vazhdojë të përmbushë detyrimin e tij të mbikëqyrjes për të siguruar që përpjekjet e trajnimit përmbushin pritjet profesionale të këtij Plani Strategjik.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ SKPK ▪ NJSHP 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Plani për trajnime të stafit mbështetës 	<p>Dhjetor 2018</p>
	<p>Aktiviteti 1.7.5: Për aq sa është e nevojshme, Këshilli do të përmirësojë ndërlidhjen e tij me Policinë e Kosovës sepse PK-ja mbështet ndjekjet penale të kryera nga sistemi prokurorial, dhe ndërlidhja e tillë është e nevojshme për të siguruar që ndjekjet penale janë efikase dhe efektive.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ KPK 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Memorandum bashkëpunimi me Policinë e Kosovës 	<p>Korrik 2016</p>
	<p>Aktiviteti 1.7.6: Për aq sa është e nevojshme, Këshilli do të përmirësojë bashkëpunimin me Odën e Avokatëve për të ruajtur rregullat efikase dhe efektive, procedurat, dhe aktivitetet e tjera që lidhen me administrimin e drejtësisë.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ KPK 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Memorandum bashkëpunimi me Odën e Avokatëve 	<p>Korrik 2016</p>
<p>Objektiva strategjike 2.1</p> <p>Rritja e stabilitetit të mandatit të prokurorëve</p>	<p>Aktiviteti 2.1.1: Përgatitja e koncept dokumentit për dorëzim në Ministrinë e Drejtësisë me të cilin mbështetet amendamenti në Ligjin për KPK-në që do të caktojë fuqinë e pranimit të kandidatëve prokuror në fazën fillestare të punësimit në Këshill.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ KPK ▪ Komisioni për Çështje Normative ▪ SKPK 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dokument me rekomandime 	<p>Dhjetor 2017</p>
	<p>Aktiviteti 2.1.2: Nëse, pas monitorimit të situatës, Këshilli konstaton se ka probleme me këtë procedurë, do të paraqesë një koncept dokument në Ministrinë e Drejtësisë i cili do të mbështesë një amendament të Kushtetutës që do të futë masa shtesë, duke përfshirë ndoshta një kërkesë të shkruar dhe vendime të arsyetuara, dhe një e drejtë për shqyrtim gjyqësor të vendimeve të mos-riemërimit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ KPK ▪ Komisioni për Çështje Normative ▪ SKPK 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dokument me rekomandime 	<p>Dhjetor 2017</p>

	<p>Aktiviteti 2.1.3: Në ndërkohë, Këshilli do të dorëzojë një koncept dokument në Ministrinë Drejtësisë në mbështetje të një amendamenti të Ligjit për KPK-në që do të krijojë një procedurë administrative të ankimit për vendime të mos-riemërimit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ KPK ▪ Komisioni për Çështje Normative ▪ SKPK 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dokument me rekomandime 	<p>Dhjetor 2017</p>
<p>Objektiva strategjike 2.2</p> <p>Themelimi i kritereve transparente dhe proceseve për rekrutim të prokurorëve, sigurimi i kompetencave të nevojshme profesionale</p>	<p>Aktiviteti 2.2.1: Këshilli do të zhvillojë dhe zbatojë një qasje pro-aktive dhe bazuara në merita të rekrutimit të dizajnuara për të gjetur dhe të emëruar një fuqi punëtore që përpiqet për të arritur përsosmërinë dhe për të përmbushur standarde të larta të sjelljes etike.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ KPK ▪ Komisioni për rekrutim ▪ SKPK ▪ NJSHP 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Rregullorja për rekrutimin, provimin, emërimin dhe riemërimin e prokurorëve ▪ Vendimet e KPK-së 	<p>Dhjetor 2018</p>
	<p>Aktiviteti 2.2.2: Këshilli do të përgatisë një dokument paraprak që do të mbështesë ndryshimet në Ligjin mbi KPK-në, sigurimin për shfrytëzimin e një trajnimi, provimi, dhe procesi të mentorimit që do të përdoret gjatë periudhës fillestare të trajnimit të kandidatëve të prokurorëve që do të promovojnë përsosmërinë e performancës.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ KPK ▪ Komisioni për çështje normative 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dokument me rekomandime 	<p>Dhjetor 2017</p>
	<p>Aktiviteti 2.2.3: Këshilli do të përdorë një proces të rekrutimit që është i qartë dhe transparent.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ KPK ▪ Komisioni për rekrutim 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Rregullorja për rekrutimin, provimin, emërimin dhe riemërimin e prokurorëve ▪ Vendimet e KPK-së ▪ Raporti i procesit të rekrutimit 	<p>Dhjetor 2018</p>
	<p>Aktiviteti 2.2.4: Këshilli do të sigurojë marrjen në punë të një fuqie punëtore që përfaqëson dallimet etnike dhe gjinore të Kosovës.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ KPK ▪ Komisioni për rekrutim ▪ SKPK ▪ NJSHP 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Rregullorja për rekrutimin, provimin, emërimin dhe riemërimin e prokurorëve; ▪ Rregullorja për rekrutim të 	<p>Dhjetor 2018</p>

